

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-2
724

DRAMË

**LONI
PAPA**

Një copë rrugë


814-2

PCY

LONI PAPA

NJË COPË RRUGË

dramë



19622

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TABLOJA E PARË

*Në orët e vona, Ela u largua nga spitali.
Jonën e takon në shtëpinë e Gentit.*

JONA — Hahaha! Ç'më ka bërë të qesh! Ke parëti?... Për Gentin them, pér Gentin!... Ishim te kodrat. U ulëm, porositëm diçka, kur, do ti, vjen Astriti.

ELA — Doktor Astriti?!

JONA — Po! Janë shokë, megjithëse Astriti është dy vjet më i madh... Astriti është beqar, ti e di.

ELA — E njoh, na bënte praktikën mësimore.

JONA — Genti e lavdëron.

ELA — Po ne marrëdhëni me mjevêt nuk mund t'i kishim si me shokët, Jona! Mbetet gjithmonë ajo e ndara: drojtja e nxënësit ndaj mësuesit.

JONA — E pse? Ai është djalë i mirë.

ELA — Ou, Jona, ty të duket çudi! Pér ty është ndryshe tani, se të tjera marrëdhënie ke krijuar me doktor Gentin.

JONA — Po, Ela!... Thuajse i kemi dhënë fund asaj dashurie të drojtur... Kam çaj, Ela (*I shërben*)... Gjë e ngrohtë pér tani në dimër. Tjetër nuk më ndodhet.

ELA — Do ta pi me shije.

JONA — Shtrydhi dhe pak limon, Ela!... Punë begari, thuaj! Dhoma është e Gentit, unë vetë rri te halla... Presim të marrim shtëpi, prandaj mos na vër re. Kur të na vish atje...

ELA — Po më vjen mirë, Jona.

JONA — Epo dolëm dhe ne, si i thonë, për të na njojur të tjerët, se mjaft e njoħiem njéri-tjetrin muaj me radħe... E, kur unë e urova Astritin që dhe ai së shpejti të ndiqte rrugën tonë — dhe Astriti ka qenë i pari që i dinte lidhjet tona — Genti i tha se ai nuk di të dashuroj. Për Astritin e kam fjalën (*Qeshin*).

ELA — Po ku ta dish?!

JONA — Jo, moj, jo! E ngacmonte Genti: «Vajti Astriti te kodrat me një vajzë. Shëtitën sa shëtitën dhe ajo i tha: «Unë po vrapoj, Astrit, a mund të më zësh?...»

ELA — Dhe Astriti?!

JONA — Astriti?! «Vrapo, po deshe, Ida, unë po të pres këtu, te stoli...» (*Qeshin*).

ELA — Duket nuk e arrinte dot, prandaj...

JONA — Jo, moj, bënte shaka Genti. Kur pi, Gentit i pëlqen të bëjë shaka.

ELA — Dhe Astriti, besoj, queshte.

JONA — Ta shihje! Kuq-kuq, si çupë! «E zure Idën, Astrit?» — i them sa herë e takoj dhe ai qesh... Shtrydhe limonin, Ela, apo s'të pëlqen me limon?

ELA — Uh, po! Më pëlqen, po harrova...

JONA — E pra!... Dhe në kokën tënde!... Po shiko, mos i thuaj «atij» se ke dëshirë të vraposh, se pastaj do të të presë te stoli... (*Qeshin*) Do më çaj?

- ELA — Jo, të falemnderit! Ti je e lumtur, Jona!
- JONA — E lumtur?! Më pyet, apo...
- ELA — Jo, them që je e lumtur.
- JONA — Prandaj dhe të fola kaq shumë për të.
Nuk e di, po se si të duket vetja kështu.
Ja, ke për ta provuar: dhe e beson dhe
nuk e beson... Të paktën unë e ndiej
lumturinë e tij në këto marrëdhëni et tonë.
- ELA — Po kjo është gjithçka, Jona!
- JONA — Po, po!... Më mbush me jetë. Them se
dhe Genti duhet ta ndiejë këtë, ndryshe
ç'u kuptua!? I kishim vënë kryq njobjes
dhe... Më ke bërë urim të çuditshëm në
çaj... Të shijoi çaji?
- ELA — Shumë... Po mos ma vër re, në s'jam
e qetë, Jona!... Kam një shok të shtruar
në spital.
- JONA — Ashtu?!... E pse është shtruar?
- ELA — Është djegur.
- JONA — Ka tri-katër ditë, apo jo?... Ai që
rrezikoi...
- ELA — Po!
- JONA — Si, moj, shoku yt paska qenë ai?! Për
të ne diskutuam në organizatën e rinisë,
ku dhe u shtrua çështja për të dalë vull-
netarë... Si, moj, shoku yt?!
- ELA — Po, shok fëmijërie! Bujar e quajnë.
- JONA — Po, po, Bujar! Ai është bërë shembull
virtuti për të gjithë.
- ELA — Nuk e di, po më erdhi krejt e papritur...
- JONA — Po ti mos u bëj e marrë e mos e lësho
veten!
- ELA — Sa herë që i binte rruga, vinte e më
takonte. Ja, para tri javësh... Dhe unë
e përcolla.

JONA — Ai prapë do të vijë dhe ti do ta përcjellësh.

ELA — Bile bëri dhe shaka, si në vegjeli: «Ela, Ela, i ka flokët me kordela!»... Unë tani nuk mbaj fjongo, po ai mbante mend se si njëherë... E, ç'kujtoj dhe unë!

JONA — Si njëherë, Ela?

ELA — Më mori fjongon dhe ia lidhi maces.

JONA — Maces?! (*Qesh*).

ELA — Unë qaja, kurse ai queshte... Qeshte dhe fërkonte macen: «Të keqen e Elës!» thoshte (*Qeshin*).

JONA — Si moj ia lidhi maces?

ELA — Lëre, ka qenë i prapë!

JONA — Ashtu janë çunat, kur janë të vegjël, Ela!

ELA — Po ç'e gjeti, thuaj!... As e pandehja ta shihja në atë gjendje.

JONA — Unë do ta bisedoj që sonte me Gentin. Genti nuk kursehet, e jo më në një rast të tillë...

ELA — Atje ku bëj stazhin mjekësor, iu luta shokëve dhe ata më lejuan ta vazhdoj stazhin në pavjonin, ku është shtruar Bujari.

JONA — Genti do ta mirëpresë, Ela!

ELA — Ju shqetësova! Më falni!

JONA — Më vjen mirë që paske një shok të këtillë!

ELA — Shok fëmijërie.

JONA — Nuk dyshova për këtë. Jam kureshtare ta takoj, më pëlqeka... Ja, Gënti thuajse ka ardhur, rri e prite! Do të vijë të më marrë e dalim bashkë.

ELA — Më vjen rëndë... Unë e njoh, po ai nuk ë besoj.

JONA — Oooo! Genti do të gëzohet, kur të marrë vesh se je shoqja ime.

ELA — Të falemnderit, Jona!

JONA — A është komunist Bujari, Ela?

ELA — E di që ka paraqitur dokumentet.

JONA — Ai tregoi madhështinë e vet dhe tërhoqi të tjerë pas, Ela... Një shok yni do të shkojë të jetojë tre vjet në kullotat alpine, bashkë me barinjtë që po dimërojnë bagëtitë atje. Epo fol e qesh, Ela! Ela, kaçurrëla!... Ja, ke për të parë, Bujari do të ngrihet dhe do të dalim unë, ti, Genti, ai... Ela, me kordela! Fol e qesh!... Tani po vjen Genti. Unë ia ndiej hapat.

GENTI — (Në të hyrë) Mirëmbërëma!

JONA — Një shoqja ime, Genti! Shoqe e gjimnazit.

ELA — Ela!

GENTI — Si jeni?

ELA — Të falemnderit mirë, doktor!

GENTI — Isha me një shok... Merret me peshkim, po këta peshkatarët gënjejnë si djalli... E gostite shoqen?

JONA — Me çaj.

GENTI — Me çaj?! Është i vetmi ushqim, themi ne mjekët, pa ndonjë dëm dhe vlerë ushqimore, prandaj mund ta pimë dhe nga një së bashku. Besoj, dy urime me çaj nuk të bëjnë keq! (Qeshin).

JONA — Dëgjo, moj Ela, se ky të turpëron kot! Kishte karamele ai, po, sa herë që del nga shtëpia... Dhe ka nja tri a katër ditë që u dha fund e nuk është kujtuar të blejë të tjera (Genti qesh). Ç'qesh ti!? Unë vetëm t'ia fsheh tani, se... (I shërben çajin) Duket Genti

do të shfajësohet për vonesën, prandaj do
të bëjë dhe shaka.

GENTI — Po kur më tha se ka arritur të zërë
peshk nga bishti me grep!

JONA — Si, si?

GENTI — Ka zënë peshk nga bishti! (*Qeshin*) Ky
qe kulmi. «Dëgjo, — i thashë, — ne mjekët
u rekomandojmë njerëzve të merren me
peshkim për të qetësuar nervat, po jo për
të gënjenyer botën!»... Ishte ai, moj, aktori
i teatrit, Nini.

ELA — Nini?! Nuk e dija se qenka dhe pesh-
katar i zoti!

JONA — I zmadhon pak Genti, Ela.

GENTI — Ika dhe e lashë... Kushedi nga do
t'ia mbajnë nesër, se të hënave e kanë
pushim. Gjer në Cem thonë se kanë vajtur,
po kush u zë besë.

JONA — Ouu, atje ka trofta, Genti! Babai im
i ka gjuajtur shumë troftat, Ela. Në mën-
gjes, thoshte ai, nxjerrin kurrizin në rreze
të diellit.

GENTI — Po kur donin të më mbushnin mendjen
e të më merrnin dhe mua me vete!

JONA — Do të vemi bashkë të gjuajmë andej,
Genti.

GENTI — Ku, Jona?

JONA — Në Cem. Dhe do t'i pjekim në tjegull.

GENTI — Ah, po, po!... Ka kohë. Apo jo, Ela?

ELA — Ç'të them unë, doktor?

JONA — Kam dalë dhe unë vullnetare, Ela.

GENTI — E, kështu, Ela!... Se u morëm me
ata, peshkatarët dhe... Po ju?

ELA — Jam në stazhin mjekësor, doktor.

GENTI — Ashtu?! Po pse nuk thua, Jona, në qenkemi të një zanati!

ELA — Unë ju njoh, doktor.

GENTI — Nuk ju kujtoj.

ELA — Vetëm një herë na keni zhvilluar leksion në vitin e dytë. Ne ishim shumë atëherë dhe...

GENTI — Hë! Kështu është: nisen me brigada, përfundojnë në individë.

JONA — Ela e bën stazhin në Gurani.

GENTI — Ju ka ardhur një kirurg i mirë atje, Abdyli.

ELA — Po, doktor, flasin mirë për të.

GENTI — Dyli, Jona... Nuk e njeh?

JONA — Jo, nuk e njoh.

GENTI — Është i zoti. Shkoi me qarkullim, po së shpejti mund ta sjellin përsëri.

JONA — Ela do të qëndrojë e do ta bëjë stazhin këtu.

GENTI — Këtu të ne?! Shumë mirë!

JONA — Në pavijonin tënd.

GENTI — Ashtu?!... Po pse s'thua?!

ELA — Më fal, doktor, nuk desha t'ju shqetësoj. Në ka mundësi...

JONA — Ka dalë vullnetare për t'i shërbyer Bujarit.

GENTI — Ehë! Atij djalit... Interesant do të jetë.

ELA — Unë shkova dhe e pashë. Gjendja është e rëndë.

GENTI — Ashtu është, e rëndë. E rëndë dhe e vështirë... Ke për të mësuar nga ky rast.

ELA — Kam për të mësuar doktor?!

JONA — Genti!

GENTI — Më falni, nuk duhet të më keqkuptoni!... Po mjekësia i ka disa terma të tillë: flas për rastin e Bujarit, Jona, se rrallë ndodh që djegia të shoqërohet me goditje në një pjesë të shtyllës kurrizore me tronditje të trurit; duket nga ndonjë shembje... Ka katër ditë që nuk përmendet. Ne vihemë përrapa vështirësish të paparashikuara: stabilizimi i gjendjes, infeksioni, temperatura... Duhet filluar nga goditja më parë, se ka irezik paralize, që ia vështirëson djegia e një sërë problemesh të tjera... Prandaj dhe u shpreha në atë mënyrë, pa të keq. E di, Jona, si na thoshte mjekëroshi Filakt, kur isha student?! Nuk di, në ta kam thënë: «Mjekësia bën praktikë mbi fatkeqësinë e të tjerëve». Më ka ngelur në mend.

JONA — Ai Filakti paska qenë një hajvan me mjekër!

GENTI — Ah, jo, Jona! Ai ishte një mjek i dëgjuar. Thënia e tij ndoshta...

JONA — Çfarë thënia e tij, Genti?! Për mjekun njeriu qenka një provë zanati?!

GENTI — Jona!

JONA — Çfarë, Jona! Ela vjen t'i ndihmojë një njeriu, për të cilin kushdo do të ishte gati, e nuk vjen të bëjë praktikë... Ja ti, praktikë do të bësh mbi të?!

GENTI — Më keqkuptove, Jona! Përderisa do të më duhet të zgjidh problemet më të vësh-tira, e quaj një rast të veçantë.

JONA — Pra, do të zgjidhësh problemet më të vështira, dhe nuk do të bësh praktikë.

GENTI — Unë nuk thashë që do të bëj praktikë.

ELA — Ju shqetësova doktor, më falni!

GENTI — Biem ndonjëherë në kundërshtim, po gjene merremi vesh, Ela. Unë, si burrë që jam, pranoj t'i përulem... Hëhëhë! Si i thonë asaj: zënkat janë krahët e dashurisë!
Apo jo, Jona??!

JONA — Po, Genti, po! Po nuk ishte rasti.

GENTI — Ela do të na falë, pra! I thashë... Tani, gati?!

ELA — Ju lutem, doktor!

JONA — Unë jam gati. Ty po të prisja.

GENTI — Më duhet të përcjell Jonën për te halla,
Ela. Besoj...

ELA — Ju lutem, doktor!

(Dalin)

TABLOJA E DYTË

Në dhomën e mjekëve zilja e telefonit bie me ngut. Në anë të kundërta nxitojnë Genti dhe Ela. Ata ndodhen përballë. Genti ngre dorezën. Ela largohet.

GENTI — Po, po!... Spitali... Nuk e njihni të sémurin?!... Po atëherë ç'kérkon, ju lutem?!... Si? Nuk u muar vesh kush qe, se asnjë nuk e njihte?!... Aaa, e keni fjalën pér atë që rrezikoi në objekt?! Bujar, e quajnë, Bujar!... E rëndë është gjendja, e rëndë... (*Lë dorezën. Ndérkohë vjen Astriti. Përsëri bie telefoni*) Ju lutem! E rëndë është gjendja, e rëndë... Po, po, e Bujarit. S'ka gjë, s'ka gjë!... Tungjatjeta! (*Lë dorezën*) Ke parë ti?! Telefonon dhe të thotë se nuk e njeh: qe një udhëtar i zakonshëm... (*Bie përsëri telefoni*) E, tani e tèpruan! Alo, urdhëro!... Po, po, Genti jam. Hë, Jona?!... Genti jam, pra, Genti... Jo, nuk vij dot, jo! Nuk mundem... Shpresoj të shihemi në mbrëmje... Mirupafshim! (*Lë dorezën*).

ASTRITI — Hë, ç'thotë Jona?

GENTI — Ç'të bëjnë dhe gratë e shkreta! Ndonëse nuk punojnë me ne, prapëseprapë jetojnë me ne: presin të takohemi në mbrëmje!

ASTRITI — Po mbrëmë si ia kaluat?

GENTI — Mirë, mirë. Ishim te halla e Jonës...
E, se na e ndërpree. Po a e di ti se ka një
të vërtetë ai?

ASTRITI — Cili?

GENTI — Ai që telefonoi... Nuk iu muar vesh
as emri, as nga vinte e ku shkonte, tha.
Një udhëtar i zakonshëm.

ASTRITI — Po, ashtu e njohën ata që u ndo-
dhën përreth: një udhëtar i zakonshëm. Dhe
duan të dinë, doktor, prandaj pyesin; jetojnë
me të... Dhe kjo nuk është thjesht një ku-
reshtje.

GENTI — Po, po!... Gjë e madhe!... Njëzetë
vjeç e nuk e kursen veten... Hë!

ELA — (Nga jashtë) Më vonë interesohuni pranë
mjekut. Ju lutem, mos na pengoni!

GENTI — A ka të afërm i sëmuri?

ASTRITI — Ela! Ela! Qenka larguar!... Secili e
ndien pranë, doktor, prandaj. Duket veprimi
i tij është pjesëz e jetës njerëzore, pa në
e njohën a nuk e njohën... Janë vogëlsira.
Dhe ne duhet ta ndiejmë pranë në punën
tonë.

GENTI — Ai është djegur keq. Nuk ka prindër?

ASTRITI — Me sa u mor vesh, eëma i ka vdekur.

GENTI — Ashtu?! (Vjen Ela).

ASTRITI — I ati u martua. Kujdesi i njerkës qe
i paktë dhe ai u rrit në shtëpinë e fëmijës.
Kjo është historia e shkurtër e fëmijërisë
së tij... Po s'ka gjë! Këtu jemi ne! Ja,
Ela erdhi të vazhdojë stazhin këtu, doktor,
dhe po i qëndron mbi krye e nuk e lë asnje
çast vetëm. Apo jo, Ela?

ELA — Si urdhëron, doktor! A mos më thirrët?
ASTRITI — Po, për të sëmurin.

ELA — Flet në kllapi, doktor!

ASTRITI — Në kllapi?!

GENTI — Asgjë, do t'i kalojë.

ASTRITI — Më falni, doktor, kthehem shpejt!
(Kalon).

GENTI — Kujdes për çdo të papritur. Ù kuptuam?
ELA — Si urdhëron, doktor!

GENTI — Eë! E kemi ca të vështirë për lëkurën,
aq më tepër sikur praktika e parë të mos
i dalë me sukses. Ky nuk paska as të afërm.

ELA — Merrni nga unë, doktor!...

GENTI — Hë!... Ti ke ardhur të shërbesh, moj
vajzë. Duhet të të kurojmë dhe ty pastaj...

ELA — Po të jetë nevoja, doktor...

GENTI — Të shohim, të shohim... I jepni sa më
shumë gjëra të lëngshme, po jo ujë. Duhet
të zëvendësojë ato që ka humbur... Solu-
cionin fiziologjik dhe plazmën mos ia ndani
Kujdes për infekzionin... A e mendoje se
do të bëje një stazh të tillë?!

ELA — Ju lutem, doktor!

GENTI — Nuk desha t'ju fyej, po mjekësia ka
shumë raste të vështira dhe sidomos ky
profili ynë... Pësojmë ngatërresa së koti.
Dhe ti, dashur padashur, në vend të stazhit,
po bën specializim. Në këtë anë ti ke një
farë humbje në formimin e përgjithshëm të
mjekut.

ELA — Ju lutem, doktor!

ASTRITI — (Vjen) U qetësua, kaloi në gjendje
gjumi. Kujdes, Ela, të mos ftohet, se mund
të na japë komplikacione të rrezikshme.
pastaj...

GENTI — Do të na duhej të këshilloheshim dhe
me ndonjë të afërm (*Në drejtim të sallës*)
A ka ndonjë të afërm i sëmuri?... Ka, apo
nuk ka?

GRUAJA — (*Nga salla*) Po, ka, doktor!

GENTI — Urdhëroni, atëherë!

GRUAJA — (*Ngjitet në skenë*) Unë jam nëna
e djalit.

GENTI — Nëna e djalit?! (*Sheh me dyshim
Astritin*) Nejse... Ela, nëna e djalit! Kaloni,
ju lutem!

ELA — Urdhëroni, nënë! (*Kalojnë*).

GENTI — Nënë?!

ASTRITI — Nuk ka rëndësi...

GENTI — Jo, këtu ka rëndësi për çështjen e lë-
kurës.

ASTRITI — Ajo pranon t'i bëhet nënë.

GENTI — Klinikisht nuk ka asnji rëndësi!...
Mpleksen këtu dëshira dhe ëndrra për një
punë më të mirë në jetën tonë. Ka dhe një
përputhje me ata që telefonuan...

ASTRITI — E pastaj?


GENTI — Hë!... «Sa mirë do të qe, sikur paskëtaj
Ç'do gjë të na shkonte vaj!...»

ASTRITI — Ti dyshon?

GENTI — Jo, jo!... Më kanë mbetur në mend,
që kur isha student. Perëndimi e mbante
autor të ditës.

ASTRITI — Ai është mikroborgjez e nuk beson
në të ardhmen, Genti.

GENTI — Po, po!... Flas për rastin e dhënë: ne
e dimë që nuk është e ëma dhe ajo e di që
nuk është i biri. Dhe ai e di... Sa mirë
do të qe, sikur paskëtaj...



19622

ASTRITI — Dhe kjo nuk do të duket më një çudi,
kur çdo njeri në veten e vetë do të mbartë
heroizmin e klasës. (*Vjen Ela*)

GENTI — Po, Astrit, po! Në sferën shoqërore ashtu
është. Në fushën e mjekësisë, kur vjen
fundi, nuk përmendet kush qe më interesanti.
Në janë bërë të gjitha përpjekjet, apo nuk
janë bërë, këtu po, mund të ketë diçka
interesante. Pa jetoi kështu e mbaroi
ashtu...

ELA — Ai duhet të jetojë, doktor!

GENTI — Dhe jo vetëm ai, moj vajzë. Kujdes,
se do të dalësh mjeke!

ELA — Jo vetëm ai, po ai... ai... ai... (*Kafshon
gishtin*)

ASTRITI — Fol, Ela! Ai u dha jetën të tjerëve!
Dhe kjo duhet të na frymëzojë në punën to-
në, doktor Genti.

ELA — Po, u dha jetën të tjerëve, doktor!

GENTI — Në mjekësi të gjithë duhet të jetojnë,
moj vajzë e mbarë! Dhe ata që nuk u japid
jetën të tjerëve...

ELA — Unë nuk ju kundërshtova, doktor.

GENTI — Në shoqëri është ndryshe, mund të veço-
hen. Në spital gjykohen sipas sëmundjeve:
në anamnezë ne marrim prejardhjen e së-
mundjes dhe shënojmë — në rastin e dhë-
në — djegie e shkallës... me ose pa go-
ditje dhe nuk shënojmë u dogj nga budalla-
llëku, ose nga mençuria. Të tjerat mbeten
një kuriozitet jashtë profesionit, që nuk përf-
fshihen në anamnezë. Kjo është dhe detyra
jonë: i sëmuri është i sëmurë. Frymëzimi
në mjekim qëndron jashtë profesionit.

ASTRITI — Ai bën të pamundurën e ti e quan një kuriozitet jashtë profesionit!

GENTI — Bota mjekësore kështu e ka, Astrit. Bota filozofike...

ASTRITI — Si mbetka një kuriozitet jashtë profesionit tonë bota e pacientit, kur dihet që secili në jetë ka një pikë fillimi e një mbarim, ku plotëson dhe karakterin e vet?! (*Ndihet kënga e nënës*). Ela sakrifikon në stazh për t'i shërbyer një njeriu. Sa mund do t'i duhet asaj të plotësojë njojuritë e veta!

GENTI — Ai do qetësi. Ai duhet të flerë, Ela! Kaloni tek i sëmuri dhe i thoni asaj gruaje, pa kënga dhe zemra... (*Ela kalon*) Pa mendo të shpikësh ndonjë gjë dhe unë kam për të të shpallur kokë të botës! Ndryshe ke për të mbetur pa kokë...

ASTRITI — Mirë do të që, por askush nuk po ta kërkon një gjë të tillë, doktor. Po dhe plogështinë e klinikës, që nuk del jashtë mureve e bazohet thjesht në një terapi të njojur... Kjo nuk është e klasës.

GENTI — Oj?!

ASTRITI — Po! Shokët e tij vijnë të jatin lëkurë, ndërsa pacienti për ne është i njëjtë, me ndryshim moshe... Ndoshta këtu qëndron dhe e keqja e nuk po dalim dot jashtë asaj guaskës së kërmillit, po zvaritemi në disa të thëna e parime të trashëguara. Po bota e pacientit, ajo bota shpirtërore, èndrrat, dëshirat, karakteri me aftësitë e paaftësitë në veprimtarinë jetësore, ku mbetet?...

GENTI — More, a e mendon ti se pasoja e goditjes ndaj djegies është më e madhe?!

ASTRITI — Njihe jetën e pacientit dhe ke për të kaluar rrezikun... (*Vjen gruaja*).

GENTI — Sa e thjeshtë do të qe, sikur biografia të ishte klinikë.

ASTRITI — Të futet në klinikë. Etika mjekësore është e njojur.

GENTI — (*Tek sheh gruan*) Më falni, shoqe, lëreni të qetë të sëmurin.

GRUAJA — Ju thashë që jam nënë.

GENTI — Nuk ju thirra për këtë: Jeni, apo nuk jeni e ëma...

GRUAJA — A keni fëmijë, doktor?

GENTI — Jo!

GRUAJA — Aaa, prandaj ti!... Po unë nuk erdha se më vinte keq, doktor, apo se ishte fëmija im. Unë e kam një djalë, ushtar e kam, në moshë të këtij... Pa provoje t'i thuash fëmijës tënd të bëjë atë që bëri ky?! Hë, sa të dhemb e shkreta zemër!... E de, se më tha dhe ajo goca të mos i këndoja më! Po është njeri i madh ai. E do këngën, prandaj i këndoja. E shoh tek hap sytë dhe harron dhembjen. Ditën e mirë!... (*Astritit*) Ku merret lëkura, mor bir?

ASTRITI — Kalojmë, nënë! (*Kalojnë*).

GENTI — Ditën e mirë!... Pram-pam-pam! Po të qe se të bëmat e njerëzve do të frymëzonin ilaçet, atëherë po! Mund të ngatërronë frymëzimi në mjekësi. Atëhere po, do të kishe rëndësi edhe ti, o moj grua, t'i shtreshe nënë. Atëhere po, mjafton të sillnim disa shembulla të tillë dhe... Pram-pam-pam! Jona frymëzohet e nxiton të të lërë hijen te dera edhe pse, në këtë rast, kërkon vlerë

për mendtë e kokës... Hë! (Në paraskenë
Ziguri ka ndjekur me vëmendje shqetësimin
e Gentit).

ASTRITI — (Në kalim) Xha Zigur!

ZIGURI — Shshsht!... Doktorin e kam parë të
mërzitur.

ASTRITI — Është ca i lodhur, xha Zigur.

ZIGURI — Ka ditë që shuan e ndez cigare...
(Genti vepron) Dhe ha bishtin e cigares.

ASTRITI — Nuk ka gjë: kur t'ia ndiejë hidhëri-
min, do ta pështyjë!

ZIGURI — Duket se e ka një hall ai, se njeriu,
kur përtyp bishtin e cigares, e ka hum-
bur!... Dëgjova se e shoqja i merret me
shkencë në bujqësi. Nuk e di në është e
vërtetë...

ASTRITI — Po, e vërtetë është. Jona Barini e qu-
ajnë, po e ka të fejuar e jo grua.

ZIGURI — E de, njëlloj është! Ajo dashka të
lërë zyrën dhe të shkojë e të punojë maleve.
Ia kishin dëgjuar emrin dhe në radio, po
këtij, duket, nuk ia paska qejfi.

ASTRITI — Nuk e di, po ti bën mirë të mos
lëvizësh shumë, xha Zigur!

ZIGURI — Atë djalin shikoni ju, se është i ri,
po mua... Nuk më hâ dreqi mua, jo! Po shkoj
e t'i them, se i mbiu cigarja në buzë...
(Ziguri shkon te Genti. Astriti vazhdon rru-
gën) Më fal, doktor, në të erdha pa më thi-
rrur!

GENTI — Urdhëro, xha Zigur!

ZIGURI — E de, se këtu në spital vetëm te ju
e kemi shpresën. Mos u mendo shumë!

GENTI — Unë?!.. Jo, jo!

ZIGURI — Megjithëse, edhe po nuk e vrave mendjen, të myket e shkreta.

GENTI — Po, po!... Duhet vrarë mendja, se nuk i dilet ndryshe.

ZIGURI — Ai djali i ri, që erdhi këtu, doktor, ai do që të jetojë.

GENTI — (Qesh) Hëhëhë!... Më bëre të qesh! Po cili është ai që nuk do të jetojë?!

ZIGURI — Po, po... Mirë e ke ti. Nuk është lojë bixhozi e shkreta, është jetë dhe, po e humbe një herë, ëhë më! Dhe megjithatë, ke parë ti, njeriu sikur nuk do ta mendojë të keqen.

GENTI — Patjetër, ndryshe as që do të kishte kuptim.

ZIGURI — Po, po! Kam qenë dhe unë partizan, po kush vinte re atëherë? Të nxirrte koka tym, kur shihje qenin që të kishte drejtuar dyfekun... Po ky?! Dyfek nuk i drejtoi njeri, gjë në qese për vete nuk shtyri. I fortë paska qenë qerratai, i fortë! E vuri kokën në torbë dhe s'e përfilli të keqen.

GENTI — Ashtu është, xha Zigur, ashtu. Ndonjëherë njeriu harron se është gjëja më e çmuar dhe nuk e përfill.

ZIGURI — E, de!... Prandaj dhe na duket çudi, doktor. Shpëtoi centralin, thonë, që të mos rrinin njerëzit pa dritë. Qerrata djalë ai!... Ika doktor, ika!

GENTI — Ditën e mirë!

ZIGURI — E, de! Se u ktheva prapë, se dhe njeriu mërzitet, kur është vetëm! Hë! Ja këtë desha të them: e di ç'i ka ndodhur një doktori në kohë të luftës?! I ka sharruar këmbën një partizani me sharrë druri. Ja, dhe kjo

atëherë na u duk një çudi, po ai e bëri... Duket në fillim kishte frikë mos i mbeste në dorë dhe thoshtë që nuk kishte vegla. Spital në male, thuaj, me gjysma veglash... Po kishte qenë kokëderr ai partizani, zemërfortë, ja, si ky çuni, e nuk pyeti pér veten: «Merre sharrën e drurit, doktor, — i tha, — dhe preje pa frikë, se dua të luftoj unë e nuk kam nge të zvarisem spitaleve!» «Nuk luftohet me një këmbë», i tha doktori. «Nuk luftohet pa kokë, — i tha partizani, — pa me një këmbë, me një dorë e me një sy...» Thamë se aq e pati, kur ia prenë këmbën me sharrë druri: kangrenë, se kishte dy ditë e dy net në dëborë. Ne i këndonim këngët tonë pér t'i mpirë dhembjen, se nuk kishim ilaç. Dhe ja, është gjallë dhe sot e kësaj dite! Një nga Skrapari... Pyet, në dac!

GENTI — Po, po, e di! Po ne nuk do t'i presim këmbën. Ai është djegur.

ZIGURI — Më fal, në të mërzita, doktor, po plakun pa fjalë nuk ke ç'e do! Ki besim tek ai dhe luftoja sëmundjen pa frikë: ja këtë desha të them!... Sa pér çështjen e djegies, pse nuk ia lyen me vezë, doktor, me vaj veze?

GENTI — Vaj veze?!

ZIGURI — Digje të verdhën e vezës, ose me gjithë lëvozhgë në tigan, gjersa të nxihet e të bëhet si vaj e lyeja herë pas here dhe ke pér të parë. Kështu e shërojnë plagën e djegies andej nga ne dhe nuk lë asnjë shenjë. Provoje!

GENTI — Mirë, xha Zigur, mirë! Shko e shtrihu tani, se dhe unë kam punë.

ZIGURI — Them të vete dhe unë të jap lëkurë.
GENTI — Të sëmurët nuk japid lëkurë: ka rregulla spitali.

ZIGURI — Lëkurën time e urdhëroj vetë unë, doktor, dhe nuk lë të ma urdhërojë njeri, se i kam dhënë kësaj Shqipërie shtatë nishane... katër meshkuj dhe tri femra. Me gjithë nipër e mbesa bëhen njëzet... Ata... ata... hë! Apo thonë se plaku jeton ditët e qenit dhe nuk i vlen lëkura, ë? (*Qesh*) Pa martohu dhe ti një herë e lind shtatë dhe pastaj hajde e llafosemi bashkë... *Kalon i gëzuar. Ndihet e goditura e shkopit*).

GENTI — Hë! Tjetër ky! Dhe mendohu dhe mos u mendo (!) Dhe të mëson si pritet këmba me sharrë druri (!) Ose lyeje me vezë, thotë... Sikur nuk ka bota vezë!... (*Tek sheh Elën që kalon*) Ja, Ela, nxiton! Dhe Jona nxiton... Ela! (*Ela vjen*).

ELA — Urdhëro, doktor!

GENTI — Jona të bën të fala!

ELA — Të falem nderit, doktor!

GENTI — Domethënë ti ishe studente e vitit të dytë dhe unë të paskam dhënë një orë leksion... Sa mirë që e mbake mend!

ELA — Studenti i mban mend mësuesët, qoftë dhe në një rast.

GENTI — Po, po! Ndonëse dhe unë, zakonisht, i mbaj mend studentët... A je ambientuar ndopak?

ELA — Po, doktor, që në ditën e parë.

GENTI — Mbaji në rregull shënimet, se do të të duhen. Praktika është plotësuese në jetën e mjekut, praktika dhe studimi i vazhduese... Çfarë thotë i sëmuri?

ELA — Është i çuditshëm. Nuk flet, vetëm vështron thellë në sy. Ka sy të gjallë...

GENTI — Ashtu??

ELA — (*Ndien se ka folur pa vetëkontroll*) Shakave të shokëve u përgjigjet me buzagash... Për të ngrënë nuk ha, mendohet.

GENTI — Ia keni përmendur ndonjëherë ç'i ndodhi?

ELA — Jo! Pse t'ia përmendim?

GENTI — Për t'i dhënë guxim, thashë, për asgjë tjetër.

ELA — Ai nuk do të dijë për të, por unë e kam gjetur dhe duke qarë. Ai nuk ka qenë kështu.

GENTI — Vërtet?! Keni kohë që e nijhni?!

ELA — Më falni, po... Mjafton dhe koha që ndodhem në spital.

GENTI — Kaq pak!

ELA — Kjo nuk ka rëndësi, doktor!... Desha të them se ai nuk mund të jetë i tillë.

GENTI — Ai qan, kur është vetëm the?!.. Duket, për sa i ndodhi.

ELA — Ai qan, se nuk ecën dot, doktor!

GENTI — Po, po! Kjo është e drejtë... Pata lexuar një shënim për një plak italian, bari delesh duket kishte qenë, që kishte arritur të shërojë në kohë të shkurtër këtë djegie, duke rigjeneruar indet në gjendjen e mëparshme, pa nevojë operacionesh plastike. Firmat kapitaliste i ofruan shuma të mëdha, po ai e mori sekretin me vete në varr, në moshën 80-vjeçare...

ELA — Po a nuk mund të ndodhet dhe te ne ky bari?

GENTI — Hë!... Sikur sekretet të ndodheshin në çdo bari! Ai italianni qe i vetmi që u dha në një lajm shkencor... Kështu pra, duhet t'i shohim gjërat më me përvojë jetësore, ndryshe rrëmbimi nuk të sjell gjë tjetër veçse pendim...

ELA — Jo, doktor Genti, ai do të eci! Unë këtë e ndiej në besimin e tij (*Ndérkohë kanë arritur në paraskenë*).

GENTI — Pfff!.. Bisedoj me ty si kolege; më çudit ky qëndrim i tij i fundit: qanë! Apo jo?

ELA — Po, ç'të them unë, doktor! Ndodhet njeriu përpara gjendjesh të këtilla.

GENTI — Ndodhet, ndodhet, por.. (*Kalon një udhëtar*).

UDHËTARI — Ju lutem, Bujarin kërkoj!

GENTI — Në numrin 13 është laboratori.

UDHËTARI — E kam pasur ndihmës, kam qenë ustai i tij.

GENTI — Më fal, kujtova se mos ke ardhur përlëkurë! Shoqëroje, Ela!

UDHËTARI — Ju falem nderit, doktor! (*Kalojnë me Elën*).

GENTI — Asgjë!.. Asgjë!

T A B L O J A E T R E T È

Dy të fejuar bisedojnë mbi kuptimin e jetës.

A.

Në dhomën e Gentit

JONA — Kushedi si do të jetë bërë Ela!

GENTI — E ç'do të bëjë Ela?! Rëndësi ka që operacioni u krye normalisht.

JONA — Dhe përfundimi do të jetë i mirë, besoj,

GENTI — Tani për tani nuk mund të them asgjë, se ndodhin të papritura dhe na rroftë suksesi pastaj... Si puna e atij telegramit në anekdotën për mjekët, që ma përmend gjithmonë Nini, kur unë i them se peshkatarët gënjejnë nga dëshira për të zënë sa më shumë peshk. Apo nuk merr dhe një qëndrim aktori në skenë: «Operacioni u krye me sukses. Pikë. I sëmuri vdiq. Pikë».

JONA — Anekdotë e bukur qenka, po sigurisht, për mjekët e pazotë, Gent.

GENTI — Jo, jo! Në raste të tillë, të sëmurin e mposht dhe një grip. Prandaj nè, mjekët,

duke nxënë mend nga ky telegram anekdotik, nuk japim përcaktime të parakohshme.

JONA — Po unë Elén e kam shoqe, Gent, dhe ajo erdhi vetë të shërbejë.

GENTI — E pastaj?! Unë nuk kam dalluar ndonjëherë të njohurit nga të panjohurit, Jona. Një gjë e tillë nuk do të më nderonte. As edhe ti nuk duhet të ma lejosh.

JONA — Më ardhka çudi!

GENTI — Ti je vetë zooteknike dhe e kupton, moj vajzë; në praktikën mjekësore, sëmundjet kurohen me ilaqe dhe, po të jetë nevoja, me ndërhyrje kirurgjikale. Frymëzimi mbetet në praktikën e aktivitetit shoqëror... Ja, për shembull, ti u frymëzove dhe dole vullnetare.

JONA — Jo vetëm unë! Janë 35 të rinj e të reja nga ndërmarrjet e ndryshme të qytetit që presin të nisen së shpejti në zonat malore.

GENTI — E pra, dhe ti me ta. Të gjithë u frymëzuan. Dhe ne Bujarit nuk i kemi lënë asgjë mangut nga kujdesi i duhur. Shoqja jote për këtë të jetë e sigurtë. Këtë mund t'ia thuash, por, me sa shoh unë, një vërejtje e tillë, as që mund të bëhet.

JONA — Ti e di më mirë, Gent, unë kështu mendova.

GENTI — Ja, kështu është! Vetë Ela i gdihet e i ngryset te koka. Interesant ajo vajzë: e qetë, e sjellë, e përpiktë...

JONA — Bujari është një i njohuri i saj, po ti mos i bjer në sy.

GENTI — I njohur, apo...

JONA — Jo, jo! I njohur.

GENTI — E shoh që merakoset shumë, prandaj...
JONA — Shokë fëmijërie... Gent, a e ke atë çan-
tën e lëkurës ti, që e kishim vjet në Po-
gradec?

GENTI — Aty éshtë. Pse?

JONA — Them ta marr me vete, kur të nisem.
GENTI — Epo ti s'ke pér t'u nisur nesër... Dhe
të gjithë përnjëherësh nuk besoj të niseni,
se nuk do të myllni institutin.

JONA — Jo! Kësaj radhe do të nisem unë dhe
Sandri... Sandri e ka pér në kullotat alpine.

GENTI — U thuaj atyre se kemi pér të bërë mar-
tesën dhe...

JONA — Ti nuk di ç'flet! Pse më mërzit, Gent?
GENTI — Qesh, pra, qesh!... (*Rrotullohen të kapur*
pér duarsh).

B

Në një kënd birrarie. Jashtë bie shi.

GENTI — Ti the se do të zëmë peshk, ë?

JONA — Po, peshk, trofta!

GENTI — Peshk, posa, peshk... trofta! Eh, do të
vemi të zëmë peshk! (*Rrekëllen gotën*) Gë-
zuar!

JONA — Përse bën kështu, Gent?!

GENTI — A thamë se do të zëmë peshk?! Një
peshk të madh e do ta pjekim në tjegull...
(*E mbush gotën*.)

JONA — Genti, unë nuk të kam fyter ndonjëherë!
(*Do t'i marrë gotën*).

GENTI — Të lutem! (*Nuk ia lë*) Kush tha se më ke fyer? Po të qe kjo, Jona nuk do të pinte në këtë tryezë. Pastaj, unë jam i fejuari i Jonës dhe këtë ajo e di, bile është gjëja që e di përmendsh dhe unë, pa e ndier nevojën që ta përsërit, nuk e harroj asnjëherë që jam i fejuari i Jonës. E pra, si mund ta fyejmë ne shoku-shokun?!

JONA — Unë të pyes e ti pi.

GENTI — Është e njëjta gië si të thuash: unë shkoj maleve, ti pi raki.

JONA — Dhe unë kuitova se ti do të më përkrahësh në mendimin tim. Dhe për ty do të ishte fyerje, po të ndahesha nga shokët... Më ardhka rëndë që ty nuk po të pëlqeka!

GENTI — Mua më pëlqen të pi, Jona, ja, kështu! Dhe të çukis në meze.

JONA — (*I ze gojën*) Jo, Gent, jo!... Të paktën, mua mos ma thuaj këtë! Ela më pyeti në jam e lumtur. Unë i thashë që dhe Genti e ndjen lumturinë time. Ajo më tha se ishte e shqetësuar për shokun e vet. Unë nuk i shpreha asaj ndonjë shqetësim.

GENTI — A ke dëgjuar ndonjëherë ti, kur thonë mori malet?

JONA — Po, kam dëgjuar! Dhe kam pasur besim se ti do të më përkrahje edhe kur ndokush mund të thoshte se unë mora malet. Dhe as që mund ta merrja me mend që Genti po loz tanë me mua me tutelën e një burri që nuk pyet për dëshira... Po vetëm do të më kapë për duarsh dhe unë të qesh. Ah, Genti, sa shumë të desha!

GENTI — E di. Dhe tanë...

JONA — Dhe tani, po aq... por pa hyrë në llögari
ritë e tua. (*Çohet*) Po më përcjell, se u vo-
nuam! (*Kalojnë gjatë paraskenës*).

GENTI — Këtu bëhet fjalë pér martesën, Jona.
Kupton, apo nuk do të kuptosh?! Në prag
të martesës dy vjet maleve... Gjithkush do
ta quante një marrëzi.

JONA — E di, se një vajzë theu një rregull: shtyu
martesën pér të dalë vullnetare! Dhe kjo
duket çudi!... Para gjashtë muajsh 18 cifte,
të rinj e të reja, sa krijuan familjet, ikën
dhe u vendosën në kullotat alpine, ku ngri-
tën fshatin e ri. Atje shkon dhe Sandri, 12
orë larg qytetit verior... Dhe kjo një çudi!?

GENTI — Jo, kjo nuk është çudi. Atje e gjetën
jetën ata, me familjet e veta.

JONA — Ashtu?! Dhe ne e gjetëm këtu, ë?! Dhe
druhemi t'i falim atdheut dy vjet nga rinia
jonë, ndërkohë që ata i dhurojnë Shqipërisë
një fshat të ri. Pa mendo: Shqipëria më
1967 ka një fshat më tepër

GENTI — (*Kthen rrugë papritur*). Natën e mirë!

JONA — Genti! Po më lë vetëm në mes të rrugës?!
(*Genti qëndron*) Unë nuk kam çadër... Dë-
gjon?

GENTI — Shiu do të pushojë.

JONA — Nuk është mirë. Të paktëm më përcill
deri në shtëpi.

GENTI — Rruga është me njerëz.

JONA — Po unë jam me ty... Ne pimë bashkë.

GENTI — Natën e mirë! (*Kalon*).

JONA — Kthehu, Gent!... Gent!... Iku!... Sikur
të kthehet përsëri! Nuk e besoj, jo! Fyhet
shpejt ai. Dhe po të shkoja unë, do të kër-

kontakte nënshtrim... Eh, Gent, Gent! (*Mërmërit një këngë*).

«U hodh një zog nga foleja,
ra poshtë e qau me cicërimë...
Përplasi krahët
dhe lart u ngrit në fluturim.

E klithi gazit rrugëve të reja,
e puthi ngjyrat në cicërimë,
me furtunën lojti lart, në qiell,
u rrit në fluturim...»

Kënga për zogun, kur nis të fluturojë. Dhe mbetet në fluturim. Bie shi. Më kujtohet njëherë kur ia një shi i madh dhe na zuri te kodrat. Nuk patëm strehë dhe u lagëm deri në palcë. Dhe unë u laga. Dhe ai. Pastaj na hynë dridhmat dhe fjaloseshim duke u dridhur! Mua shiu më këllonte nga flokët dhe fustani më ishte ngjitur pas trupit. Vetëm kur qeshnim, nuk dridheshim. Cudi!... Pastaj nga nxeh-tësia e trupit ne po avullonim... avullonim!

Jona në rikujshtim:

GENTI — Shih çfarë avulli! Rrezik të avullohesha e gjitha, Jona!

JONA — Mos merr frymë përpara meje, Genti!

GENTI — Pse?

JONA — Më avullon fryma jote... (Të qeshura).

GENTI — Ti e ke hundën të vogël, Jona!

JONA — Vërtet?

GENTI — Po!... Unë kam një mendim, Jona.

JONA — Çfarë?

GENTI — (I pëshpërit) *Bie shi!*

JONA — *Mos, Gent, mos!... Hoho, çfarë shiu!*
Shiu... shiu...

Zëra të mbytur: *Shiu... shiu... shiu!*

Unë shtrydhja flokët. Ai me pëllëmbë të dorës fshinte vetullat dhe sytë... Dhe tani bie shi. Ditët e shiut nuk harrohen lehtë. Unë tani rri nën strehë të mos lagem...

ASTRITI — (Vjen) Mirëmbrëma! Bie shi, Jona!

JONA — Mirëmbrëma, Astrit!... E zure Idën?

ASTRITI — (Qesh) Vrapon si djalli, Jona, dhe nuk e arrij dot. Po ti këtu?

JONA — Më zuri shiu dhe mbeta. Dhe se si të duket, kur pret të pushojë dhe nuk pushon.

ASTRITI — Ku është Genti?

JONA — Në punë duhet të jetë!

ASTRITI — Sikur e kishit lënë të takoheshit.

JONA — Po!... Kishte diçka urgjente, më tha. Unë dola njëherë, po...

ASTRITI — Dhe prandaj je e shqetësuar, apo...

JONA — Pak rëndësi ka kjo për të tjerët, doktor!

ASTRITI — Si pak?! Unë i shqetësuar, ti e shqetësuar, tjetri i shqetësuar: një për shokun, një për familjen, dikush... dreqi e di! Po ku shkojmë pastaj? Të vjen keq sikur të bisedonim?

JONA — Po ju dëgjoj, Astrit!

ASTRITI — Për Gentin e kam fjalën, ka ca mendime të çuditshme, lidhur me atë djalin, Bujarin... Bisedoj me ty, Jona: të lutem, mos më keqkupto.

JONA — Ju dëgjoj, doktor, ju dëgjoj!

ASTRITI — Me trajtimin ndaj pacientit ne nuk për-
puthemë: Genti trajton sëmundjen dhe ha-
rron të sëmurin në jetën e tij.

JONA — Po, doktor! Dhe mua më ka shqetësuar
sjellja e tij. Më shumë në hallet familjare,
që tani për tani nuk dua t'i bëj për fjalë.

ASTRITI — Më fal, në desha të di!

JONA — Asgjë nuk ka, jo!... Është si puna e asaj
Idës, që ai vetë e tregon: nuk më lë as të
vrapoj e jo më të më pres te stoli. Më drejt:
unë nuk dua të shkoj duke marrë me vete
dhembjen e Gentit.

ASTRITI — Dhembjen e Gentit?! Ai është mjek i
aftë, Jona.

JONA — E di, Astrit, dhe unë u rrëmbeva në pa-
sionin e tij, ndërsa ai... Pra mbetemi me të
drejta të pabarabarta. Dhe kjo më dhemb,
sidomos tani që do të jem larg. A po më
përcillni, doktor?

ASTRITI — Po, po!... Nuk ju vjen rënd sikur për
Bujarin.... Më fal, të mos keqkuptohemi:
ne bashkë do të përpinqemi me Gentin, por,
si të thuash...

JONA — Kujdesin kryesor ta keni ju?... Do të
bënët mirë.

ASTRITI — Ndoshta mund të biem dhe pak ndesh.

JONA — Do të më qetësonit, doktor (*Kalojnë. Vjen
Genti. Ai thith cigaren me shqetësim*)

Rikujtohen zërat

ELA — Ai duhet të jetojë, doktor! Ai... ai...

GENTI — Po pse vetëm ai, moj vajzë?!

ELA — Jo vetëm ai, po ai...

JONA — Hoho, çfarë shiu! Shiu... shiu!

Zëra të mbytur: Shiu, shiu... shiu!

GENTI — (*Qëndron atje, ku më parë ishte Jona*)

As ka ndër mend të pushojë dhe ky shi!
Më mirë të bëjë vapë sesa të bjerë shi e të
na freskojë! Kështu që nuk i gjendet kësaj
pune... Po, sidoqoftë, shiu është i mërzit-
shëm, se të mbyll brenda, megjithëse njerë-
zit kanë gjetur çadra për të... Djalli e mori!
Në palcë të dimrit ngrihet e bija e botës e
të lë shakull në mes të rrugës...

ASTRITI — (*Vjen*) Sa u ndava me Jonën, doktor!
Nxito, e ke përpara!

GENTI — Më duhet të shkoj në spital, Astrit.
Jam vonë.

ASTRITI — Ishte e shqetësuar për ty.

GENTI — U ankua?!

ASTRITI — Jo, jo!... Po do ta lë vetëm, tha.

GENTI — Aha! Ka për-t'u qetësuar në punë.

ASTRITI — Bela!... Njoh një shok, që kishte
shkuar atje dhe më tregoi se e kishte ca të
vështirë... Po e keqja e kishte gjetur me
gruan: nuk do që t'i vejë pas!

GENTI — Ashtu e kanë gratë: ca nuk duan të ve-
në pas, ca ikin pa pyetur.

ASTRITI — Hë!... Nuk qenke në qejf, doktor.

GENTI — Jam mjek-roje dhe më duhet të kthe-
hem në spital... Më fal, po vjen autobusi!
Natën e mirë!

T A B L O J A E K A T È R T

*Ela mundohet të mposhtë gjendjen
e shqetësuar.*

A.

Pranë krevatit të Bujarit. Ela tregon një ëndërr.

ELA — Unë kam parë një ëndërr. Unë jam e re
dhe mund të shoh ëndrra. Apo jo?

BUJARI — Po, po! Mund të shohësh.

ELA — Pashë sikur loznin një vajzë e një djali. Po,
sakaq, ajo vajza shpërtheu në një gaz të
papërmabjatur. Dhe ai djali filloi të qeshte
e deshi t'i afrohej pranë. Po ajo u vrenjt...
Pastaj ajo vajza se si u shndërrua në trë-
ndafil.

BUJARI — U shndërrua në trëndafil?!

ELA — Po!... Po trëndafili u bë përsëri vajzë.

BUJARI — Ehë!... Pastaj?

ELA — Dhe pastaj fryu një erë e madhe, e madhe...
dhe vajza u zhduk. Dhe djali u gjend në ca
pyje të dendura duke e kërkuar... Dhe m'u
bë sikur ishte ngritur një fshat i tërë pér
ta kërkuar. Nëpër fletët e drurëve hynin rre-

ze dielli. Dhe tē gjithë ndiqnin sorkadhe, po sorkadhe nuk zinin dot...

BUJARI — Nuk zinin dot?! Përrallë e bukur!

ELA — Nuk éshtë përrallë, éshtë éndërr... Aq tē lodhur e ndiente veten ai djali, sa filloi tē térhiqej zvarë, zvarë. Pastaj...

BUJARI — Pastaj ajo u bë përsëri vajzë.

ELA — Ku e di ti? Secili éndrrën e sheh vetë dhe s'mund tē shohë éndrrën e ndonjë tjetri.

BUJARI — Janë përralla, Ela, përralla për tē më vënë në gjumë.

ELA — Ti je i keq! Unë po tē tregoj éndrrën e ti... Hajt tani, fli! Natën e mirë!

BUJARI — Duket më prisje tē tē vija me ndonjë tufë lule... Dhe tani sheh éndrra... Hë! Éndrra.

ELA — E pse mendon kështu, Bujar? Unë nuk e dija se paske qenë kaq guximtar. Kam kujtuar se je më shumë i rrëmbyer sesa guximtar.

BUJARI — Guximtar pa këmbë!... Ai djali térhiqej zvarë, Ela?

ELA — Mos fol marrëzira! Ti do tē ecësh... Dhe, kur tē ngrihesh, do tē tē jap unë një tufë me lule.

BUJARI — Doktoresha do tē më sjellë një tufë lule, doktoresha që tani kujdeset për mua tē rri shtrirë... Pthu! Më rëndet vetja.

ELA — Mjaft tani, fli!... Thuamë natën e mirë!

BUJARI — Natën e mirë!

ELA — (*Zë vend në tryezën e infermieres së rojes*) Pavijoni éshtë i madh. Muret janë lyer me bojë vaji tē bardhë. Shtretrit janë ngjyrë gri... Ka dhe dy orë natë. Të sëmurët flënë.

Unë jam këtu, në tryezën e infermierës së rojës. Prej këtej shpërndahet drita e zbetë e abazhurit... (*Mbetet tek sheh Bujarin të çohet. Ai kryen veprimet*) Ç'bën ky?! U çua nga krevati?! Dhe po mundohet të ecë?!. Shih, ai po zvariset anës së murit! (*I vete pranë*) Hë, hidhe dhe një hap! Dhe një hap!... (*Do ta ndihmojë*).

BUJARI — Lermë!... Dua të eci vetë.

ELA — Po, xhan! (*Korrigjon nën vështrimin e Bujarit*) Vëlla... Kështu kemi thënë, që unë të kam vëlla e ti më ka motër. E mban mend?

BUJARI — Atëherë unë kisha dy këmbë dhe fluturoja, ndërsa tani, kur mundohem të eci... (*Provoni*)

ELA — Hë, dhe një hap! Dhe një hap...

(*Bujari lëkundet, duke ndier dhembje therëse, dhe bie në krahët e Elës. Errësim i çastit. Ela nxiton me gjilpërë në dorë. Vjen xha Ziguri, pastaj Genti.*)

ZIGURI — Ç'të bëjë fukarai! Do të ecë...

GENTI — Po ti?! Të tjerët flenë.

ZIGURI — Nuk kam gjumë.

GENTI — Qëndroni në vendin tuaj!

ZIGURI — Kam kohë unë për të bërë gjumin e madh. Ky është i ri... (*Tërhiqet mënjanë*).

GENTI — (*Elës*) Po ti, ku ishe?

ELA — Këtu. Nuk mendova se do të ndodhte...

GENTI — Mendove, the?

ELA — Doktor, ju lutem!...

GENTI — Ai nuk duhet të lëvizë dhe ti këtë e di.

BUJARI — Desha ta provoj, po rashë, doktor!

GENTI — Pse lëvize, atëherë?

BUJARI — Se nuk dua tē vdes, doktor! Po ja që u turpérova!

GENTI — Turp éshtë kur thyen rregullat. Po tē ishe pérplasur, kush do tē përgjigje?

BUJARI — Unë vetë, doktor. Po nuk lëviza, ku shedi sa do tē qëndroj kështu.

GENTI — Të shërohesh. pa nuk ka rëndësi koha (Në tē ikur) Kujdes tjetër herë! (Kalon).

ZIGURI — Ashtu éshtë, o bir, si thua ti. Koha éshtë e vyer si pér tē vegjlit, si pér tē më-dhenjtë, pa lëre doktorin ti... Ja, mua duan tē më nxjerrin në pension. Po ç'të bëj unë në pension, tē ngroh vezët?! Qetësia éshtë vdekje, pa lini doktorët ju, se atë punë kanë ata, tē këshillojnë... Dëgjoni këtu plakun! Më kujtohet kur isha djalë e dola pér gjah. Dola pér arinj. I mata malet këmbë pér këmbë. po në ari nuk ndesha. Megjithatë vrava trembëdhjetë thëllëza dhe një alamet lepuri. Naaa, ma kishte kokën! Po tanis?! (U bie këmbëve) Ç't'u bëj tē shkretave tanis?! Këtë më thuaj! Prandai them unë që pleqëria éshtë vdekje. po këtë doktori nuk e beson... Më falni që ju mbajta konferencë, po... (E ndërpret Genti që sa ka hyrë).

GENTI — Nuk paske ikur në vendin tënd ti, Ziguri!!

ZIGURI — Ika, doktor, ika!... (Në tē dalë) Po kështu e kemi ne, pleqtë, nganjëherë harrjomë ç'na thonë.

GENTI — I sëmuri ka nevojë pér qetësi.

ZIGURI — E mora vesh. Natën e mirë! (Del).

GENTI — Natën e mirë!... Ela!

ELA — Urdhëro. doktor! (I vete pranë. Gjatë bisedës kalohet në paraskenë, ku ndodhet dhe një stol).

GENTI — Jepi pak librium. Me qetësinë do t'i kalojnë dhe dhembjet... Në të fola rëndë, mba je këtë mësim në jetë: «Më mirë një fjalë të vrazhdë, sesa një gabim të rëndë!» E sheh, pra, sa ka fusha e mjekësisë?! Ti përpinqesh të vësh diçka në vijë e përpara të del diçka e pamenduar... Të mërzita, në të fola, po kujdes!

ELA — Jo, doktor! S'ka gjë!

GENTI — Je vajzë e re, po në këto përpjekje do të mësosh dhe ti.

ELA — Po, doktor!

GENTI — Tani t'i jepet qetësuesi dhe kujdes! Nësër, po të ketë marrë veten, do ta kontrollojmë imtësisht... S'duhet të lëvizë, se ka dhe plagët e acaruara.

ELA — Sikur t'ia afronim krevatin pranë dritates, se nuk ka ajër, thotë, nuk ka dritë.

GENTI — Mirë, kjo mund të bëhet: me kujdes, se mos e ftoh dritarja!

ELA — Po, doktor!

GENTI — Çojeni me gjithë krevat atje. Kështu?

ELA — Mirë, doktor!

GENTI — Shko e qefësohu dhe ti pak! Natën e mirë!

ELA — Natën e mirë!

B.

Po aty, pas disa ditësh.

GENTI — Më dukesh e lodhur, Ela. Ke nevojë për pushim?

ELA — Jo, doktor, të falem nderit!

GENTI — E sheh? Po të mos e kishe ndryshuar vendin e stazhit, nuk do të kishe tërë këto andralla.

ELA — Unë erdha vetë, doktor. Po do të më vijë keq, nëse gjendja e tij nuk do të përmirësohet plotësisht. U bë një javë që ai nuk po lëviz dhe e shoh që është bërë më i ngrindur me veten...

GENTI — A mund të flasim zemërhapur?

ELA — Si të dëshironi, doktor!

GENTI — Mirë atëherë! Të sëmurit nuk do t'i tregosh.

ELA — Jo, doktor!

GENTI — Këto kohë, ti e sheh, ai ka një kontraksion si pasojë e ngritjes së parakohshme.

ELA — Po, doktor!

GENTI — Dhe kjo e dëshpëron së tepërm... Atë dhe ty, besoj. Po?

ELA — Po!

GENTI — Kaq kisha.

ELA — Unë kam besim. Ai shpreson se do të ecë.

GENTI — Kjo është e domosdoshme për të sëmurët dhe një detyrë për mjekët. Sëmundja, pas asaj lëvizjeje të pamenduar, që në të vërtetë qe një stërmundim, mund të vijë duke u acaruar, e paralizimi... Qartë?

ELA — Po, ndonëse nuk dua të besoj.

GENTI — Pse?

ELA — Vetëjeta e jonë atij do t'i jap jetë, doktor.
(Vjen Astriti).

GENTI — Një teori më vete! E pakuptuar!

ELA — Unë po mundohem ta provojë, doktor...
Krahas mjekimeve, sigurisht.

GENTI — Mëso më parë, vajzë, pastaj provo!... T'i

shérbehen mjekimet e duhura. Kalo në kujdes të të sémurit, vajzë, kalo!

ELA — Si urdhéron, doktor!

ASTRITI — Të lutem, Ela, prit pak!

GENTI — Jo, kalo ti, Ela (*Ela në mëdyshje*) Kalo, vajzë, kalo! (*Ela kalon*).

ASTRITI — Pse nuk e le, doktor?!

GENTI — Nuk ishte e nevojshme. Ajo është e re dhe unë i thashë ç'duhej t'i thosha. Kaq mjafton.

ASTRITI — Ti fole sinqerisht me të?

GENTI — Unë me nxënësit e mi flas sinqerisht.

ASTRITI — Po me veten tënde a ke folur ndonjëherë sinqerisht?

GENTI — Astrit!... Ju dyshoni në sinqeritetin tim?

ASTRITI — Kur erdha u::ë, ti e le bisedën përgjysmë, doktor.

GENTI — Unë nuk pata ndonjë bisedë me ju.

ASTRITI — Doktor Genti! Po kërkoni të vrissni dashurinë e tyre dhe kjo nuk ju nderon.

GENTI — Unë nuk e di një gjë të këtillë, por edhe nëse... Të mos i tregoja të drejtën mendon ti?! Po kjo c'do të ishte? Do të kisha bërë një krim të vërtetë, po të mos i têrhiqja vëmendjen për të ardhmen. Ajo është vajzë e re.

ASTRITI — Po për jetën e atij tjetrit nuk mendon ti?! Dhe ai është djalë i ri.

GENTI — Të raktën, kaq ndershmëri si mjek duhet ta kem.

ASTRITI — Doktor Genti! Po i ndërpret shpresat një njeriu. Kjo nuk i falet një mjeku. Dhe mos harro se ajo e dashuron. Dhe ai, për hir të saj, përpinqet të fitojë qoftë dhe mbi pamun-

dësinë e parashikuar. Është bota e tij ajo dhe ti këtë duhet ta shfrytëzoje, që i sëmuri të mposhtë goftë edhe dëshpërimin e shkaktuar nga gjendja në të cilën ndodhet. Po ti këtë nuk e bëre.

GENTI — Hë!... Një temë interesante do të qe sikur njerëzit të shëroheshin me dashuri. Nejse, do të mbylleshin spitalet, po edhe sikur të qe kështu, do të ishte e vështirë.

ASTRITI — Pse?

GENTI — Ela është vajzë e re. Kur isha student, Astrit, njëherë... Kishte rënë dëborë: dëbora e parë në ditën e Vtitit të Ri. Atëherë unë bëja praktikën vjetore. Vajzat dilnin të drojtura, se topat e dëborës u vinin krejt papritur nga të gjitha anët. Djemtë qeshnin, ato vraponin dhe u ruheshin të goditurave. Nuk e di pse këto të gjuajtura më ngjanin si një komunikim i pastër midis djemve dhe vajzave në lojë të përbashkët. Kur ndodhte që ndonjëra kundërshtonë çamarokët, atëherë lufta bëhej më e ashpër... Ndodhi që unë shoqëroja një shoqen time. Ne kaluam përmes rrugës — edhe aty ku gjuhej me dëborë — po ne nuk na gjuajti kush me dëborë. Ndoshta unë nuk e vura re, por kjo e dëshpëroi shumë shoqen time. Kur mbaroi rruga jonë e gjatë, rruga e paluftë, ajo tha: «Para dy vjetësh, sa shumë më gjuanin dhe mua me dëborë!» Më erdhi keq që ajo, shoqja ime, doli nga rrethi i lojës pa luftë. Dhe Ela është e re dhe nuk ka dalë jashtë rrethit të lojës, në fushën e mëshirës, kur

askush nuk mund ta gjuajë më me dëborë...

Dhe ti e ndien këtë, po nuk e thua.

ASTRITI — Ela!

ELA — (Nga jashtë) Urdhëro!

GENTI — Mos e shqetësoni Elën, ju lutem! Dhe,
në e bëtë një gjë të tillë me mua, ajo është
e re. Ajo... (Tek sheh Elën, hesht).

ASTRITI — Doktor Genti është i shqetësuar për
fatin tënd, Ela.

ELA — Për fatin tim?! Më fal në ju shqetësova,
doktor!

GENTI — Asgjë, asgjë, vajzë! Unë ju shqetësova,
po, sigurisht, pa ndonjë mendim të praptë
dhe pa u ngutur nga gjaknxehtësia ose nga
pasioni.

ELA — Për këtë më thirrët, doktor?

ASTRITI — Jo, desha të të pyes, përse e dashuron?

ELA — Doktor, më fal, po vështirë të të përgjigjem.

ASTRITI — Fol, Ela! Ka rëndësi, pavarësisht në
ke mësuar dhe ndonjë gjë të pasigurtë e të
paqenë. Në këtë rast, unë do të kundërshtoja
cilindo.

ELA — Atëherë po mundohem, doktor. Po... po do
të ishte e njëjta gjë sikur të më pyesnin
përse njerëzit lindin fëmijë?

GENTI — E drejtë, vajzë e urtë, e drejtë!

ELA — Unë mendoj se dashuria është djepi i jetës,
prandaj lindin dhe duan të lindin fëmijë.

ASTRITI — Djepi i jetës, doktor!

GENTI — Në botë lindin dhe pa dashuri.

ELA — A mund t'ju shqetësoj, doktor Genti?

GENTI — Jujeni nxënësja ime, Ela! Ju lutem!

ELA — (Astritit) Doktori ka një të fejuar.

GENTI — Nuk është fjala për të, Ela!

ELA — Mirë, nuk po bëjmë fjalë për të (*Astritit*)
Mendoni sikur ajo të mos e donte. Fëmijë
pa dashuri . . .

GENTI — Të lutem, Ela!

ELA — Nuk po ju shqetësoj më gjatë, doktor
(*Astritit*) Më pyetët përsë e dashurova Bu-
jarin . . . Po dhe ai ka diçka të veçantë, nuk
e përfill aq shumë veten, sa mund ta përfillim
ne të tjerët. Isha vajzë e re atëherë dhe kjo
më shembëllente me një botë të madhe.

GENTI — Po, është një moshë e tillë, kur vajzave
u duket dhe hëna si çupë. Dhe flasin me të.

ELA — Jo, doktor, unë nuk u gënjeva në dashurinë
time. Jeta për të ka qenë e ashpër dhe shpesh
u përplas në paudhësira të moshës. Duke
mbartur me vete dhe dëshpërimin e prindër-
ve . . . Kështu pra, ai filloi të mos e përfillte
veten . . . Po ju shkon e bisedoni me të,
doktor! Ai deri tani nuk ka fyter kërkënd.

GENTI — Ashtu?! . . . Kalojmë, pra!

GENTI — Më thanë se nuk e ke përfillur veten.

BUJARI — Nuk po ju kuptoj doktor!

GENTI — Ke qenë i prapë në jetën tënde.

BUJARI — Nuk e di . . . E kush jua tha këtë doktor?

GENTI — Ela!

BUJARI — Nuk ju ka treguar të vërtetën . . . Ndo-
shta për të më lehtësuar ose për të më shfa-
jësuar përpëra jush, kur unë grindem me
veten.

GENTI — Pse?

BUJARI — Dua tē çohem.

GENTI — Dhe pas asaj që ndodhi?

BUJARI — Mundohem, doktor!

GENTI — Ashtu?!... Derisa tē thyesh kokën, duke lozur me jetën... Tē paktën atë vajzë lëre tē qetë dhe mendo pér gjendjen!

BUJARI — Më vjen keq, doktor, po Ela nuk ka treguar tē drejtën. Ajo nuk më lë asnje çast tē qetë... Dhe, në jam bërë i prapë, pér hir tē saj jam bërë. Këtë nuk jua tha?

GENTI — Jo!

BUJARI — Kam dashur tē godas njërin me grusht.

GENTI — Ti?

BUJARI — Po, pér hir tē saj! Prandaj them se Ela ka fshehur tē vërtetën... Lutju dhe ajo do tē tē tregojë më thjesht se unë.

ELA — Po, po! Ashtu është, doktor, dhe unë nuk e fsheh: `është një çast i jetës sime, që unë nuk desha ta bëj pér fjalë... Një ndajnate u vonova te një shoqja ime. Ah, po!... Kishim detyrat e laboratorit që i zgjidhëm së bashku. Pér tē arritur sa më parë në shtëpi, unë ia preva shkurt, rrugicave, po pa dashur hyra në rrugë qorre dhe u ngatërrova aq keq, sa nuk po dija ku tē dilja. U ktheva mbrapsh e s'kaloi shumë, kur m'u afrua një djalë... Thashë se m'u zu fryma! Në rrugë nuk kishte këmbë njeriu e pipë zëri nuk ndihej asaj ane...

GENTI — Mirë, moj vajzë, mirë! Unë, si mjek, nuk ta fsheha tē vërtetën.

ELA — Po në atë rast më mbrojti Bujari, doktor.

GENTI — Sa e padjallëzuar që je, moj vajzë, dhe nuk e kupton që kje nuk ka asnë rëndësi pér gjendjen... Ti do të jesh mjeke. Unë pér të kaluarën nuk të bëra fjalë.

ELA — (*E turpëruar*) Po ku ta di unë e shkreta se ç'desha të tregoja dhe u ngatërrova fare...

GENTI — U hutove, thuaj.

ELA — Thashë se e fshehta ime do të kishte rëndësi. Më falni, në gabova! (*Kalon e rrëmbyer*).

GENTI — Kujdes në mjekim, vajzë!

ASTRITI — Nuk desha të të ndërpres, Genti, por, po tē gjykoje shpirtin e saj tē madh, edhe në atë tregim tē ngatërruar...

GENTI — Atëherë do ta gjykoja jetën përciptazi.

ASTRITI — Jemi shokë e nuk po fyhem, doktor!

GENTI — Flas pér atë tē kaluar. Ajo është vajzë e re dhe i duket sikur ato marrëdhënie kanë interes tē veçantë.

ASTRITI — Ato kanë interes tē veçantë dhe duhen shfrytëzuar pér tē mposhtur acarimin e mëtejshëm tē sëmundjes... Dhe kjo nuk na falet.

GENTI — Oj?! Si thua ti, tē pranoj unë që pasojet e goditjes në shtyllën kurrizore nuk acarohen në lëvizje tē pàrakohshme?!

ASTRITI — Jo!... Unë them se ti nuk do tē kuptosh se ata, në çdo hap tē jetës së përditshme e ndiejnë veten si në luftë. Dhe kjo nuk ka si pérjashtohet, se është bota e tyre, Genti, pér tē mposhtur sa më parë gjendjen në tē cilën ndodhen... Se, fundi i fundit, kjo është dhe bota e jonë.

GENTI — Aaa, Astrit! Dole jashtë shkence dhe u hodhe në politikë. Të lutem!

ASTRITI — Nuk ke pse fyshesh, Genti! Ne të fyer jemi përderisa druhemi të dalim jashtë një mendimi të trashëguar të mjekësisë së humanizmit të përgjithshëm, se mos e lidhim shkencën me politikën. Dhe nuk është e fyer ajo, Ela, në përpjekjet e veta, dhe Bujari, apo Jona që ikën maleve e merakosur përfatim tênd.

GENTI — Jona u tha për këtë?

ASTRITI — Fjala është për Bujarin. Poho, Genti, poho! Pohimi jep jetë?

GENTI — Ti e pe përfundimin e asaj lëvizjeje të pamenduar.

ASTRITI — E pashë.

GENTI — Ç'kérkon të pohoj atëherë?

ASTRITI — Dashurinë e Elës dhe karakterin këmbëngulës e të rrëmbyer të Bujarit: dy ndihmësit tanë të guximshëm.

GENTI — Ja pra që nuk përputhem.

ASTRITI — Unë jam komunist dhe mbaj përgjegjësi të plotë për sa them të veprohet.

GENTI — E di. Dhe unë mbaj përgjegjësi, ndryshe do të më duhej të largohesha nga pavijoni.

ASTRITI — Pse? Ndihma e jote është shumë e nevojshme.

GENTI — Hë!... Ndihmë e pavlerë!

ASTRITI — E kush jua tha këtë?

GENTI — Pram-pam-pam!... E kush mund të ma thotë tjetër, përvèç shokut tim?

ASTRITI — Unë po e kërkoj ndihmën tênde. Pa tê unë do ta kem të vështirë.

GENTI — ...

ASTRITI — A mendon se mund ta ndryshojmë dhe mjekimin?

GENTI — Me çfarë? Me vaj veze?

ASTRITI — Po! Analiza laboratorike jep të dhëna.

GENTI — (Qesh) Hahahaha! Sikur nuk ka Amerika vezë, Astrit! Apo nuk ka dhe kora breshke t'i djegi e t'i mbrujë me vaj ulliri?!

ASTRITI — Ka. Dhe ne i kemi medikamentet e tyre, po labi e mjekon brenda tri javësh, pa lënë shenjë, duke rigjeneruar indet, siç bënte ai, bariu italian... Ndërsa ne na duhet viti, duke ia lënë shenjat e djegies për gjithë jetën.

GENTI — Më vjen keq!... Ti dëgjon Zigurin, që nuk di çfarë flet?! Më fal, doktor, po ndihma ime në këtë rast është e kotë.

ASTRITI — Shokë jemi dhe nuk e pandehja të më lije në baltë.

GENTI — E po, përderisa nuk përputhem... .

ASTRITI — Megjithatë unë do të mundohem.

GENTI — Mundohu, mundohu, po mos i thuaj njëriu, se do të qesh me shkencën tënde të mje-kësisë... Hahahaha!

ASTRITI — Poho, doktor, poho!... Diç di dhe ai popull nga përvoja, që ne duhet ta provojmë e ta fusim në praktikën tonë mjekësore.

GENTI — Hë!... Vaj veze! Të uroj sukses!

ASTRITI — Nejse!... Këtë nuk e prisja.

C.

Bujari ndien paralizën.

ELA — Ja edhe krevatin ta prumë te dritarja! Tjetër çfarë do?

BUJARI — Oooo, më kënaq rrezja e diellit, Ela, megjithëse hyn skic! Tani, po të duash, hiqja perdet fare! Më duket sikur më mbyllin brenda.

ELA — Ja edhe perdet po ia heqim! (Vepron) Tjetër?

BUJARI — Tjetër?! Ti e di çfarë dua...

ELA — Ej, ike?... Shiko rri mirë se ta çova prapë krevatin ku e kishe.

BUJARI — Po, moj motër, po! Ke të drejtë ti, po ç'të bëjë unë, kur më ke zënë ters??

ELA — Të rrish mirë aty e të mos lëvizësh, atë të bësh!... Bilé të më thuash «urdhëro!» e «si urdhëron!».

BUJARI — Mirë, mirë, po të tëra do t'i shpaguash, pastaj!

ELA — Nga ti?!

BUJARI — Nga unë. Ja, këtu do të jemi!

ELA — Eh! Budallai që nuk nxe mend!... Të dhemb më shpatulla?

BUJARI — Kjo e djathta më dhemb ca. Duket u vrava, kur desha të eci.

ELA — Do të provosh përsëri?!

BUJARI — Si thua ti?

ELA — Mendoj se po!... Jo, nuk duhet: doktor Genti thotë jo! (Tek sheh Bujarin që do të çohet) Mos, Bujar, mos!

BUJARI — Shshshsht! Mos i trego doktorit! Ouu!
(*Shëmbet në krevat*).

ELA — U vrave?!... Të ka motra xhan, mos! Ti
je djalë i keq... Si nuk ma dëgjove një
herë fjalën, xhanëm?

BUJARI — Të kam thënë mos u merr me «vaga-
bondët».

ELA — (*Shtiret*) Pse mërzitesh ti?! Unë nuk t'i
shava «shokët».

BUJARI — Shokët e mi?!

ELA — Po! Dhe atë ustani tënd «të çmendur».

BUJARI — Eh, q'njeri është ai, Ela!

ELA — E si deshi të të ngrinte me forcë nga kre-
vati ai, apo...

BUJARI — Ai nuk ta jepte traktorin po të mos
thyje kokën, moj! Po ti nuk e njeh atë,
prandaj!

ELA — Oj??!

BUJARI — Hë, nëne, nëne! Një metër e gjysmë
dëborë në Lugjet e Hamzës! Aty ma dha
për herë të parë traktorin. Apo nuk qe ajo
fryma e bjeshkëve në atë dëborë...

ELA — Pastaj, Bujar?

BUJARI — Kisha këmbë atëherë.

ELA — Unë nuk të pyeta pér këtë.

BUJARI — Më fal, Ela! U kujtova që ta kam tre-
guar njëherë, prandaj... (*Vjen Astriti*).

ELA — Unë nuk mbaj mend!

BUJARI — Jam lodhur! Ndonjëherë tjetër...

ASTRITI — Ç'thotë Bujari?

BUJARI — Ç'të them, doktor! Përrallisemi!... Si
është Ida, doktor?! (*Ela kafshon gishtin dhe
i bën shenjë të heshtë*).

ASTRITI — (*Qesh*) Hahaha! Dhe ti e paske marrë
vesh?! (*Heton Elén*).

ELA — Më fal, doktor! Mua ma tha Jona, po Bujari...

ASTRITI — Asgjë për t'u shqetësuar, Ela, asgjë!
Më pëlqen... Ja, vrapon si djalli dhe nuk e zë dot, Bujar!

BUJARI — E dëgjon, Ela?

ELA — Po, po, Bujar, e dëgjoj.

ASTRITI — Po pse shqetësohesh ti, Ela?

ELA — Jo, doktor, po... Nuk ka lezet.

BUJARI — Më fal, doktor! Nuk kam ç't'u bëj këmbëve, prandaj dhe ndonjëherë... Nuk na mbeti gjë tjetër vec të kujtojmë vegjelinë, duke u ngushëlluar për këtë shtyllë të copëtuar dhe këto këmbë të paurdhëruara. Doktor Genti më urdhëron të mos lëviz...

ASTRITI — Po, doktori... Nuk është puna për rregullat e spitalit, po ndoshta tani për tani...

ELA — Ai fyhet kur e këshillojnë të mos lëvizë, doktor. I duket sikur do të mbetet për tërë jetën ulok.

ASTRITI — E kush e tha këtë? Në radhë të parë nuk duhet të shqetësohet e të mos mendojë se, për hir të shëmtimit të mjekrës, do t'i pritet koka.

BUJARI — Kërkon të më vërë përpara, doktor! Unë e ndiej paralizën, ta marrë djalli, ta marrë! Është e ndyrë, të topit, ta ha shpirtin!

ASTRITI — Aaa, Bujar! Në spital nuk bisedohet për gjëra të tillë. Rri e mendon marrëzira, sikur ta kesh kaluar jetën fushë me lule.

BUJARI — Hë!... Fushat e mia me lule!

ASTRITI — Epo atëherë?

BUJARI — Ç't'u bëj këtyre, doktor, t'i hedh tej?

ASTRITI — Bujar!

BUJARI — Më fal, doktor!

ASTRITI — Pa çohu pak! Me kujdes! (*E ndihmon me Elën.*)

BUJARI — Më lëshoni tani!

ASTRITI — Aaa, jo, jo! Hidhma dorën në qafë! (*Ia hedh atij dhe Elës*) Pa mundohu të ecësh!... Hë! (*Bujari lëviz me vështirësi*) Shumë mirë, hë! A qëndron vetëm me Elën tani?... Ashtu, se dua të shoh pak. (*Largo-het ca. Bujari gati rrëzohet i këputur. Astriti e kap*) Mirë! Hajde tani në krevat! (*Veprojnë*).

BUJARI — Hooo! U mbusha me frymë.

ASTRITI — Nuk është aq e lehtë, por tani po bindem se ti mund ta mposhtësh.

BUJARI — Haaa! Më dolën djersët, doktor!

ASTRITI — Qetësuhu! Po vetëm mos u ço kurrë.

ELA — Hajde, Bujar! Binte dëborë... Te Lugjet e Hamzës, Bujar.

BUJARI — Ohu! Ela! Do të kujtojmë kohën kur kishim këmbë, doktor!

ASTRITI — Ka rëndësi dhe kjo.

ELA — Ka rëndësi, thotë doktori, Bujar! Binte dëborë!... Dëbora në Lugjet e Hamzës (*Në sfumimin e ambientit Ela dhe Astriti kalojnë në paraskenë, ku takojnë dhe Gentin. Bie dëborë*) Dëbora ishte e ngrirë. Një metër e gjysmë dëborë... Ty të thirri ustai.

GENTI — E ç'ka të bëjë kjo me spitalin, moj vajzë??

ELA — Ai ende nuk po tregon... Doktori thotë se ka rëndësi dhejeta e pacientit.

ASTRITI — Po të lutet Ela, Bujar!

ELA — Ja, filloi!... (*Bujari dhe ustai në skenë. I ka lodhur moti.*)

BUJARI — Brrr! Dhe kjo dëborë në Lugjet e Hamzës nuk paska të mbaruar, usta!

USTAI — Na vuri në gjumë, na vuri!... Hajt, merrë traktorin e të nxjerrësh trungjet.

BUJARI — Unë të marr traktorin e të nxjerr trungjet?!

USTAI — Ty, more po të them, ty!

BUJARI — Në atë rrugë unë nuk e kam ngarë kur ka qenë kohë e mirë, jo më tan i me një metër e gjysmë dëborë!

USTAI — Socializmi do trima në prova të vështira, djale.

BUJARI — Me rrezik koke?!

USTAI — Unë do të jem pranë teje dhe do të të drejtoj... Po të jetë bashkë do të rreziko-hemi.

BUJARI — Usta! Koka vlen më tepër nga një trung!

USTAI — Çfarë the?! E pse, nuk e di unë se koka vlen më tepër nga një trung?! Po ti as ke pér t'u bërë kurrë komunist, po nuk e more traktorin në këtë ditë të vështirë. Unë i pari nuk të jap rekomandim se po më trembesh nga një metër e gjysmë dëborë... Ja, zgjidhi punëtorët që po të rrinë pa punë, dhe pastaj caktoje vlerën e kokës tënde! Po e kalove këtë rrugë të vështirë, ti hyn pa frikë në jetë. Se është më e madhe ajo e nuk është aq e vogël sa mund të duket ty... Si thua?

BUJARI — Ashtu qoftë! usta! Shkojmë e i nxjerrim.

USTAI — Shko e ndizë traktorin! (Dalin. Ambienti zhdukët.

ELA — Është ai, doktor Genti, që na pyeti ne dhe unë e shoqërova pér te Bujari... Kështu i krijonte ai situatat pér nxënësit e tij, duke pritur çastet më të vështira pér t'i provuar në jetë... Bobo, ç'kishin hequr! I kujtuan aty! U ishte prishur dhe traktori e Bujari, pas gjashtë orësh, duke mbajtur drejtimin e rrugës sipas lisave, kishte arritur të nxjerrë trungun e parë e ta sjellë në kantier... Aq qe sa u ça rruga! Të tjërë traktorë kaluan pas tij.

GENTI — Po, vajzë, po! Të dhëna biografike interesante pér lavdinë e së kaluarës.

ASTRITI — Ah, jo, Gent! Ustai i tij ishte komunist dhe nxënësit i provonte duke shkelur mbi pamundësinë. Dhe Bujari kështu u rrit, duke shkelur mbi pamundësinë. Dhe ai përsëri kërkon të shkelë mbi të. Pér kaq duhet të besojmë.

GENTI — Ela! (*Ela hesht*) Besoj më dëgjon. Dua të flas me ty.

ELA — Me mua?

GENTI — Po! Vetëm me ty.

ASTRITI — Më falni! (*Largo het*).

GENTI — Vështromë në sy! (*Ela nuk e vështron*)
Të lutem, vështromë në sy!

ELA — Po ç'është nevoja të të vështroj, doktor!

GENTI — Ne jemi vetëm.

ELA — Vetëm?! Ç'do të thotë jemi vetëm, fshehtësi?

GENTI — Jo, mund të flasim hapur! Kaq kërkoj.

ELA — Po ju dëgjoj, doktor.

GENTI — Nuk dua të rropatet kush në botën time, prandaj... Ti je nxënësja ime dhe besoj se do të më kuptosh. Po?

ELA — Unë do të bisedoj me Jonën. Ajo do t'ju kuptojë më mirë nga cilido.

GENTI — Jona! Jona! Më të forta malet se Jona! Malet ia fashiten dashurinë... Hodhën hijen e rëndë dhe unë nuk ndiej më të ngrohtë, nuk mbushem dot me frymë e dridhem, rropatëm me malet, me Jonën dhe me shqetësimin tim — ashtu si thotë një këngë. Më pati mbetur gjithmonë si thumb në tru ajo këngë: «Nuk di kujt t'i ankohem!»

U ankohem maleve,
malet më largohen!
U ankohem fushave,
fushat zbuturohen!

Duket ky paskam mbetur unë me dashurinë e humbur dhe me krenarinë e thyer... Dhe çapitem, çapitem! Djalli e mori!

ELA — Po doktor Astriti ç'mendim ka?

GENTI — Astriti?! Unë nuk kam dashur ndonjëherë ta nxjerr veten në ankand. Dhe në bisedova me ty, do të desha t'i shfaqem një njeriu, moj vajzë. Ndoshta dhe pér të mbrojtur mendimin tim.

ELA — Bujari më ka mbrojtur me grushtin e vet, doktor. Jona do t'ju ndihmojë më tepër nga cilido.

GENTI — Ela!... Jam i ndershëm pér sa them.

ELA — Askush nuk dyshon doktor!... Tungjatjeta! (*largohet*).

GENTI — Ela!... Ja tek mbeta vetëm! Ndodh në jetë që njeriu mbetet në një pikë e nuk mund të ecë më tej dhe i duket sikur ndien

një farë qetësie, krijohet një joshje e rrëme
dhe i tekët të këndojet. Harron veten në
këngë, sa për t'u gënjiyer... Çapitet i vetëm!
I vetëm!... Takova një të verbër dhe desha
ta shoqëroja për t'i treguar rrugën. «Jo, —
më tha, — se e gjej vetë!... Çdo rrugë që
e përshkoj, e mbaj mend!» Unë mbeta ve-
tëm... (Vë re që ka hyrë Astriti) Aaaa, dok-
tor Astriti, më fal!

ASTRITI — Unë nuk e pengova mendimin tënd,
Gent.

GENTI — Sidoqoftë, nuk është mirë! Njeriu ka ne-
vojë të bisedojë dhe me veten. Unë po bise-
doja.

ASTRITI — Më falni, atëherë! (Tërhiqet).

GENTI — Unë jam vetëm.

ASTRITI — Përsëri ju nuk jeni vetëm, doktor.
Unë erdha të këshillohem.

GENTI — Ehë! Kujtova se u larguat. Do t'ju lu-
tem... Unë mbeta vetëm! E kupton, mbeta
vetëm! Në mendimin tim, desha të them...
Ju i shihni gjurmët e mia mbi ballë. Dhe
thinjat mbi tëmtha m'i shihni! Unë nuk i
dëshirova ato, po ja që u formuan vetveti.
A mund t'u shmangesh? Provova një rast
të këtillë, desha të fshija rrudhën mbi ballë,
po m'u formua dhe një tjetër. Një thinje
dhesa ta shkul... Më dhembi, se rrënjen ia
nxora me gjak.

ASTRITI — Ti ankohesh, doktor?

GENTI — Jo, gjykoj. A mos po e rëndojmë veten
më tepër nga c'duhet me halle të paqena
dhe thellojmë rrudhat e shtojmë thinjat?

ASTRITI — Mundet, Gent! Dhe pastaj ndodh si
me Kalin e Qyqes.

GENTI — Jo, nuk e njoh!

ASTRITI — Është një shpend që, ndryshe nga shpendët e tjerë, duket se ka pak ballë, ku i formohen rrudha.

GENTI — Kalë interesant qenka!

ASTRITI — Duket sikur gjithë hallet e botës ai i ka mbi kokë, por i vetmi hall i tij është se nuk e di ku ta shpjerë qyqen për verim. Dhe ku nuk e shëtit i ziu Kalë! E megjithatë, qyqja i qahet... Prandaj populli, përata që ankohen në jetë, thotë «Si e ke qyqen?» — domethënë hallin, që gjithmonë ankohesh.

GENTI — Po, po! Po dhe në u ankova, kujtova se isha vetëm.

ASTRITI — Ti askurrë nuk ke për të mbetur vetëm, Gent, se, edhe po të duash, nuk të lëmë ne.

GENTI — Do të desha të bisedoja me Jonën...

T A B L O J A E P E S T È

Një intermezo me Jonën dhe Gentin

A.

Te stoli Genti pret Jonën.

GENTI — Erdhe, Jona??!

JONA — Unë prita se mos vije ti, po ti... Kokën tënde që kokën tënde! Si nuk u interesove një herë ç'bën ky jeri, rron, apo nuk rron?!

GENTI — Ku e di ti që nuk jam interesuar?!

JONA — Po duket ajo! Dhe në atë copëz letër që më kiske shkruar: «Të pres. Genti.»... He! thashë me vete. Si i harroi ky tërë ato fjalë të bukura?!

GENTI — Pse, çfarë doje ti?

JONA — Po ti më përparrë më shkruaje «Të puth, Genti» ndërsa tanë «Të pres»... Po sikur dhe e huaj të isha pér ty.

GENTI — E, mirë, mirë! Të zbriti inati? Se, kur marrin inat gratë, digjet fshati, themi ne.

JONA — Ouu, rri, Genti se më ke mërzitur... Apo si atë ditë që më le në shi (!)

GENTI — Më tha halla se kishe ndenjur dhe pa ngrënë, ë?

JONA — Kush të tha, halla?! Nuk e di halla punën tonë, jo! E ja tek po ta them: të mos kishe lënë atë copëz letër, pa do të më shihje ti këtu.

GENTI — E, meqë erdhe, tani qesh! (*E kap nga dora*).

JONA — Ouu, Genti!... «Natën e mirë!» E kujt i flet ti ashtu?

GENTI — I flas Jonës, të bukurës sime, të mirës sime, që na dha dhembjen e kokës.

JONA — Mirë, mirë... Hajt tani, ku e ke atë çantën e madhe të lëkurës?

GENTI — Hë! Po pse, me gjithë mend do të shkosh ti, Jona?

JONA — Po pse, si thua ti, të mos shkoj?

GENTI — Domethënë ti këtu paske ardhur për çantën!

JONA — Jo, unë nuk erdha për çantën... se, në mos një çantë, një trastë e gjej për ta marrë me vete. Unë erdha për ty!

GENTI — Atëherë mëso se na kanë dhënë shtëpi.

JONA — E di që na kanë dhënë shtëpi.

GENTI — Na e kanë dhënë të jetojmë të dy.

JONA — Edhe këtë e di.

GENTI — Po ti mendon të ikësh maleve, moj vajzë.

JONA — Po të mendoja ndryshe, do të gënjeja veten, Genti! Mendo se sa e çiltër do të isha unë në atë shtëpi, kur arrita të gënjej vreten! Eh, jeta bashkëshortore pastaj!... Prandaj, të lutem, mos më detyro të bëj diçka që nuk dua ta bëj!

GENTI — Dëgjo, Jona! Unë nuk jam fëmijë. Kup-

ton?! Po të isha fëmijë, do të besoja lehtë e do të harroja shpejt. Ti nuk më do.

JONA — Po të qe ashtu, unë nuk kam frikë që ta them.

GENTI — Eh, djalli e mori! Nganjëherë më duket sikur të tjerët kanë hyrë në botën tënde, në dëshirat dhe interesat e tua, duke më lënë mua jashtë asaj bote... I papërfillur!

JONA — Gent, mua nuk më detyroi kush të vija këtu.

GENTI — Hë! Atëherë mund të kalosh e qetë, bile dhe pa më përshëndetur... Dhe kështu do të krijohet një përrallë: «Na ishin njëherë dy të fejuar...». Nuk mbaj mend ndonjë përrallë që të fillojë kështu. «Na ishin njëherë dy të fejuar: Ajo quhej Jona; Ai, Genti!» Dhe të gjithë e kanë pér ta dëgjuar me vë-mendje: «Ajo, Jona, e la atë midis rruge!...». E la atë midis rruge! E fortë!

JONA — Gent!... Unë dua ta ndiej detyrën e burrit në botën e tij, po jo fyerjen. Apo u mërzite ti dhe më lajmërove të çmallesh dhe të më përzësh... Kjo nuk është dashuria, Gent. Unë ende nuk e di në po shtiresh, apo më do vërtet.

GENTI — Hë! Në prag të martesës ende nuk e di në e do i fejuari?! Hahahaha!... Çudi!... Të foli gjë Ela?

JONA — Përse të më flasë Ela? Ajo do Bujarin dhe Bujari e do atë. Bujari nuk ka këmbë — Ela është e bukur. Shumë do ta donin Elën, po ajo do Bujarin. Kjo është bota e tyre... Po bota jonë, Gent?! Kush është bota jonë?! Bujari çohet, përplaset, përsëri

cohet. Dhe në e ndalon ti të lëvizë, ai përsëri cohët. A e ndien ti kush është Bujari?! Me të është Ela.

GENTI — Nuk jam mirë! Më dhemb koka.

JONA — Të dhemb koka?! Po mua, si kujton ti, nuk më dhemb koka?! Dhe dhembjen e këkës ma dhe ti... Ndërsa ty të dhemb koka për mend.

GENTI — Si, si? Nuk të dëgjova mirë!

JONA — Për ato që mendon, desha të them. Më fal, në u shpreha gabim!... Na shqetësove jetën, na shqetësove! Tërë këtë kohë më është dashur të hetoj mbi dashurinë time, mbi ndërgjegjen dhe rininë time dhe mbi familjen tonë. Kam thirrur veten në gjyq. Kupton, veten! Dhe kjo qe më e vëshitira. Çfarë do ti?! Do të ligjerojmë martesën, që të bindesh se unë të dua?

GENTI — Dhe pastaj do të shkosh?

JONA — Po, do të shkoj!

GENTI — Hahahaha! Bukur dhe kjo! Dhe fëmija më i zgjuar i botës nuk do kishte shpikur një lodër më të bukur se kjo! Kemi kohë të fejuar e tani u dashka të endemi të martaar, sa të ngrohim një çerdhe! Hahahaha! Bukur!

JONA — Aaa, dhe kjo qenka për të qeshur!... Po atëherë, kush tjetër të rëndoka e të prish gjumin?

GENTI — Marramendja jote më rëndon!

JONA — Hajde me mua, nëse nuk qenka e udhës të shkojë e fejuara «vetëm» maleve.

GENTI — Jona, nuk je më vajzë e papjekur të bësh ashtu si të teket ty. Tani ke hyrë në

të tjera detyrime, në detyrime familjare, që kanë të tjera rregulla e sjellje. E kuption, apo nuk do ta kuptosh se në familje ai gjyqi yt është i paktë, prandaj, përpara se të vendosësh, mendo!

JONA — Po, Gent, derisa vendosa, isha në ankth. Dhe dije se unë mund të gjeja edhe një mijë arsyе për t'i bërë bisht, po të thashë, thirra ndërgjegjjen në gjyq. Dhe prandaj gjyq tjetër nuk do të pranojë, qoftë dhe të burrit tim. Tani më lejo të shkoj e të takoj më parë atë pacientin tënd! Ditën e mirë! (*Largohet*).

GENTI — Bukur!... Ditën e mirë! Në hetim dashuria, rinia dhe familja! E vështirë! Dhe iku duke marrë me vete rininë dhe dashurinë e vet. Po për mua kjo mbeti një dashuri e humbur, një familje e papërfilluar... Kush ka të drejtë? Po të mos më dhembte koka, do të thosha ajo. Dhe ja, gjyqi i të tjerëve ndonjëherë qenka i pavlerë ndoshta ngaqë nuk arrijmë të kuptojmë botën e vërtetë të atij që gjykojmë. Djalli e mori dhe këtë kokën time! Më dhemb, Jona, më dhemb!... Tani na duhet të gjykojmë veprimet tonë në lidhje me të vërtetën. Ky quhet vetë-kontroll dhe duhet të përputhet me vlerën shoqërore, ndryshe ka mundësi të dalësh jashtë binarëve. Ti mundohesh të përligjësh veten dhe këtu fillon e të dhemb koka... Ouuu! Paskam dëshirë të loz një lodër fëmijësh për t'u çlodhur. (*Del*).

B

Pranë Bujarit, Ela!

BUJARI — Ke parë ndonjë ëndërr tjetër, Ela? Po jo me sorkadhe, se rrëzohesh.

ELA — Ëndërr?! Nuk shoh ëndrra unë.

BUJARI — Shoqja mjeke, ju lutem patericat! Ushtar Bujari, gati për të kërcyer pupthi!

ELA — (*Kërkon poshtë krevatit*) Patericat?!... Ku janë patericat?! (*Bujari qesh*) Mos qesh: ti këtu i kishe!

BUJARI — Bënë këmbë dhe vrapiuan patericat, shoqja doktoreshë.

ELA — Po ç'janë këto, Bujar! Do të të flasë doktori. (*Bujari qesh*) Po ti nuk je në vete! Ne të porositëm paterica të reja dhe ti po me londra... (*Shkon dhe merr patericat nga fundi i skenës*) I paske thyer?! Po pse e bëre këtë?

BUJARI — Po nuk mund të vrapoj pas teje me paterica, Ela! Dhe... Dua të ta them në vesh këtë të dytën.

ELA — E çfarë do të më thuash? (*Ai qesh*) Qesh ti, qesh, po ta rregulloj unë ty!... As do të dish ti, kur doktori më flet mua! Apo ti bën fjalë e unë ha të sharrat! Mirë, mirë! Të gjitha kam për t'ia thënë doktorit e ta marrësh vesh se kush je ti dhe ta shohim pastaj si do të të vijë për të qeshur!

JONA — (*Në të ardhur*) Ela!

ELA — Jona!... O, sa mirë bëre që erdhe, Jona!

JONA — Po unë prita se mos vije ti, po ti as u duke.

- ELA — Më fal, Jona, po nuk kam pasur kohë.
- JONA — Ky është Bujari? Ai trimi që flasin të gjithë?! (*Përshëndeten*) Si je, Bujar?
- ELA — Është shoqja ime, Bujar.
- BUJARI — Më ka folur Ela për ty, Jona... Ja, si më sheh!
- JONA — Bile ca thonë se ishe hedhur nga muret e spitalit.
- BUJARI — Nga muret e spitalit?! E dëgjon, Ela? Mendo sikur të isha hedhur vërtet, kushedi ç'do të thoshin!
- ELA — Shiko, i ka thyer patericat! Nuk ka ditë që të mos ha të shara; ky i bën e unë...
- BUJARI — I kam inat, Jona, dhe nuk e di se si më duket... Ndoshta ngaqë kam parë ca me paterica dhe se si më duket vetja.
- ELA — Ia porositëm dhe të reja, pa le... Shiko, moj, si i ka bërë copë-copë! Nuk vrapij dot, thotë, me patericë.
- JONA — Mirë e ka, nuk vrapihet me paterica. Ti e ke fjalën për të vrapiuar pas Elës, Bujar?! (*Bujari dhe Ela mbeten*) Hë, ti, ti!
- BUJARI — Jo, jo!... Po ja, mendo «çak-çak! Çak-çak». Shkon rrugës dhe të duket sikur të gjithë të vështrojnë: «I shkreti djalë, me paterica!».
- ELA — Nuk të thotë njeri ashtu, jo! Thua ti.
- BUJARI — Hë tani! Hajde e mbushi mendjen Elës! Moj, e kupton që unë nuk dua ti shoh me sy?
- ELA — Epo' merru vesh vetë me doktorin tani, se unë... Mjaft më!
- JONA — Me kë, me Gentin?
- ELA — Aman, moj Jona. Për gabimet e këtij përgjigjem unë, sikur të jem unë e sëmurë dhe

jo ky. (*Bujari e Jona qeshin*) Rri, Bujar, se nuk je fëmijë! Të paktën mendo dhe për mua! (*Merr patericat*) Aman, moj motër, se nuk është për të qeshur... (*Qesh dhe vetë*) E çfarë t'i them unë Astritit?

BUJARI — Unë nuk kam kërkuar paterica, pse i sollët? A të kam thënë që do të eci vetë? Pikë. Dhe Gentit ia kam thënë dhe Astritit. Me paterica, po të duash, ec ti! (*Jona qesh*).

ELA — Ja, e dëgjon?.. Nuk ke faj ti, jo!

JONA — O ç'më kënaqe! Nuk kam qeshur ndonjëherë kaq shumë!.. E, moj Ela, se nuk u bë kiamet. Ja, tregoja dhe i thuaj se Bujari nuk i do.

BUJARI — A të lumtë! E sheh sa mirë e gjeti Jona?! E ç'do të më bëjnë ata? Do të më nxjerrin nga spitali; unë atë dua.

ELA — E mirë, mirë!.. Gentin e takove, Jona?

JONA — Po, e takova!.. Të kujtohet, Ela, kur erdhe në shtëpi? Më pyete në isha e lumtur.

ELA — Po pse?

JONA — Po ti a je e lumtur?

ELA — Ç'të të them unë! Po të rrijë ky mirë, unë e lumtur jam... se bën nganjëherë... Le tani që iu mbyllën dhe plagët!

BUJARI — Ne grindemi, Jona, grindemi. Mua më vjen inat me veten, kjo qesh.

ELA — Do që të eci, Jona, po ngrihet dhe përplaset.

BUJARI — Dua të vrapijë e jo të eci, se, për të ecur, unë mund të eci dhe me paterica, ose pa to fare.

JONA — E di që të paskam zili, Bujar!?

BUJARI — Të falem nderit, je e para që më ke zili! Po këtë më mirë thuaja Elës.

JONA — Po tē mē thërrisni nē dasmën tuaj, atje
do tē kércejmë tē dy, Bujar! Le tē mos dojë
Ela, pér inat tē saj! (*Ela i bën shenjë Buja-*
rit tē mos tregojë pér marrëdhëni e tyre).

ELA — Po ne jemi shokë, Jona.

BUJARI — Po, po! Motër e vëlla! (*Qeshin*).

JONA — (*Në gazzmend*) Do tē kércejmë fort, Bujar,
kur tē marrim Elén, se ti nuk ke frikë tē
thuash: «Unë po vrapij, a më ndjek?» (*Elës*)
Ai nuk tē pret te stoli që, kur tē lodhesh ti,
tē shkosh e t'i ulesh pranë, po tē ndjek de-
ri nē fund tē botës. Ápo jo, Bujar?

BUJARI — Po, Jona! Prandaj dua dhe tē vrapij.
Dhe Ela këtë e di.

JONA — Ela, ta them si motër, tē kam zili.

T A B L O J A E G J A S H T È

Ela dhe Astriti në të ardhur vërejnjë Gentin, që ka mbetur i vetëm në dho-mën e mjekëve, me jakën e pardesysë të ngritur dhe me çantën e lëkurës në dorë.

GENTI — Na ishte njëherë një mjek... Një mjek që qëndroi në mes të rrugës, se e fejuara i iku. Ai desh ta zërë, po nuk e zuri dot. Pastaj... Ç'na iu shkrep këtij mjeku të blejë akullore, ndonëse ishte dimër. Do ta hante akulloren mjeku dhe fishekun do ta hidh-te në kosh, te mbeturinat... Ta marrë djalli, ta marrë! Ku jemi?.. Në një çast m'u dha e desha t'i vrapoja pas, por m'u duk vetja shumë e fyter dhe s'e bëra. M'u duk tamam si një fëmijë, që kërkon të lozë, «cicmic». Do të doja të më kishte parë edhe pse unë iu fsheha... Do të doja!... Ptfu! Sikur njeriu të kishte mundësi të pështynte veten (*Merr çantën dhe e vendos diku*).

ELA — Shih, doktor Genti!.. E pashë tek qëndronte në mes të sheshit dhe më thanë se

kishte ndenjur derisa u larguan të gjithë,
kishte ngritur jakën e pardesysë dhe pin-
te cigare.

ASTRITI — A e takoi Jonën?

ELA — Jo! Atë e kishin përcjellë njerëzit e shtë-
pisë dhe shokët e punës.

ASTRITI — Ai duket të jetë drojtur t'i afrohet.

ELA — Drojtur thua, apo nuk ka dashur.

ASTRITI — Derisa doli ta përcjellë... Duket e ka
përmbajtur sedra.

ELA — Shiko si ka mbetur, i hutuar.

ASTRITI — Pa t'i flasim. Ela! Si je, Genti?

ELA — Jo, Astrit, të lutem! (*Kalon*).

GENTI — Më sill pak sapunin, Ela!

ASTRITI — A ishe sot te Jona?

GENTI — Isha, Astrit, isha.

ASTRITI — E ku e caktuan atë?

GENTI — Nuk pata rast ta takoja.

ASTRITI — Nuk ke bërë mirë, Genti.

GENTI — E di, e di... Po kisha harruar çantën
në shtëpi dhe, sa vajta ta marrë, autobusi
ishte nisur. Dhe unë mbeta. Mbeta midis
sheshit... Eh, Astrit, do apo nuk do, koha
bën të vetën dhe lë gjurmë.

ASTRITI — Ashtu është, lë gjurmë, por edhe fshin
gjurmë. Kështu është ndërtuar kjo, se ndry-
she do të ishim disa kallëpe, që nuk do të
lëviznim nga vendi.

GENTI — E, pra! Po gjurmët janë gjurmë... Rri e
mendoj! Dreqi e mori, thuaj! Kur ecën një
ari, lë gjurmë mbi déborë. Pas gjurmëve nxitojnë
gjahtarët. Përse nxitojnë, për ta ftuar
në dasmë?

ASTRITI — Sigurisht që jo!

GENTI — Kështu pra, kryet e ariut ndodhet te gjurma e vet. Bujari eci, ë?

ASTRITI — Po, Gent! Ka përmirësime të dukshme.

GENTI — Prandaj, pra, po mendoja dhe për gjurmët, po hetoja veten... Po ka dhe gjurmëtë opingave të druvarit, kur shkon në pyll me sépatë për të prerë dru. Pas gjurmëve mund t'i shkojnë fëmijët për të gjetur babanë ose për ta ndihmuar... Ta marrë djalli çantën, se më la në mes të rrugës! Atje qeshnin, atje uronin, unë mbaja çantën. Ptfu! M'u duk vetja i pavlerë, Astrit, tamam si një gjurmë që nuk lë gjurmë.

ASTRITI — Gjurmë pa gjurmë?!

GENTI — Po! Si gjurma e pavlerë e shkopit të një njeriu që ecën rrugës. E kujt i duhet ajo gjurmë?

ASTRITI — Po, doktor Genti, po!

GENTI — Kë do të zgjidhje ti? Gjurmën që të ha kokën, gjurmën e opingës që thellohet nga barra e punës, apo gjurmën e shkopit të atij plakut që kaloi rrugës pa zhurmë?... Në do të ma thuash një fjalë bindëse, thuama, unë jam i shqetësuar!

ASTRITI — Ti shqetësöhesh kot, doktor, dhe ndoshta e vret mendjen për gjëra të parëndësishme.

GENTI — Po e vras, more, se jam njeri, prandaj! Kam dhe arsy, kam dhe ndjenjë.

ASTRITI — Njeri është dhe Ela.

GENTI — Ju thashë një herë, Astrit. Atë lëreni, se është vajzë e re!

ASTRITI — Njeri është dhe Jona, që ti nuk arrite ta takoje.

GENTI — Po njeri jam dhe unë. Dhe më dhemb këtu! (*Tregon zemrën*) Dhe askujt nuk i dhemb më tepër se mua. E mendon ti këtë?! Mbeta vetëm!... Vetëm, si lejleku sqep-e-këmb-e-qafëgjatë, duke përpjekur krahët të gjejë ushqim.

ASTRITI — Ti e le si Idën, të vrapojë, Genti, dhe vetë e prite te stoli!

GENTI — Vështirë t'i arrijmë, vështirë! Çapitjet në jetë qënkan të neveritshme. Unë vetëm u capita, nuk munda të vrapoj pas saj! Çapitje! Hë!... (*Ndez cigaren dhe përtyp bishtin e cigares*) Çapitje!...

ASTRITI — Pështyje bishtin e cigares, Gent!

GENTI — Më duket se po ta përtyp, më ngroh. Nuk e kam pasur një mani të tillë (*Vjen Ela*).

ASTRITI — Shko dhe e tako Jonën, mos prit sa të kthehet.

GENTI — A thua?

ASTRITI — Do të bësh mirë! Erdhi dhe Ela, doktor!

GENTI — Më falë, Ela! Kujtova se ishim vetëm.

ELA — Më kërkua sapunin, doktor. Unë e solla, po ju ende nuk keni mbaruar bisedën dhe mua më mbeti sapuni në dorë.

GENTI — Falemnderit!... Tani shkoni te i sëmuri dhe qëndroni me të! Astrit, po t'ju duhet ndihma ime..

ASTRITI — Patjetër, Gent, po ti e ke dhënë atë ndihmë.

GENTI — Po, po! Po jo sa duhet... Kështu, Ela?

ELA — Ju kuptova, doktor! (*Nisel*).

GENTI — Ah, jo! Prit pak, të lutem! Si është e gjendja e tij?

ELA — Ju e dini më mirë, doktor.

GENTI — Po, unë e di... Dëgjo, moj vajzë! Siç e sheh, unë kam një këmishë të kollarisur e të hekurosur mirë: pra, jam mjek! Këmishën ma shohin bota se si e kam, ndonëse të brendshmet unë e di se sa të vjetra janë. Them që ato të mbajnë ngrohtë... Në praktikën tonë këmishën e ndërrojnë shpesh, ndërsa të brendshmet më rrallë dhe na bien erë djersë po nuk u ndërruan...

ASTRITI — Bien era thartirë.

GENTI — Po, erë thartirë? Kaloi, Ela! (*Ela nuk kalon*) Ah, po! Ju kërkova sapunin (*Si e sheh që e ka në dorë*) Më falni, e paskam marrë! Më ndodhi si puna e atij që nuk di ku ka lënë kapelen dhe kërkon e kërkon sa lodhet, fundi e gjen mbi krye. Kalo te i sëmuri, Ela! Qartë?! Unë po shkoj të laj duart (*Ikën*).

ASTRITI — Duket është tronditür shumë, ndonëse mundohet ta mbajë veten, dhe mirë bën. Duhet pasur kujdes; ti, Ela, duhet t'i qëndrosh pranë.

ELA — Po ç'të bëj unë e shkreta! Atij ndofta do t'i duhet...

ASTRITI — Po, e drejtë! Ai ndihet i lodhur e ka nevojë për njerëz të afërt. Unë i thashë të shkojë te Jona... (*Në të dalë ndihet e goditura e shkopit të xha Zigurit, që hyn në skenë*).

ZIGURI — Ela!

ELA — (*Kthen*) Urdhëro, xha Zigur!

ZIGURI — Doktori duhet të eci, moj bijë, dëgjomë mua ti!

ELA — (*Qesh ciltër*) Ç'flet kështu, xhaxha!? Doktori ecën.

ZIGURI — Ai, moj... djali, desha tē them, se ne pleqve kështu na rrëshqasnin fjalët.

ELA — Po dhe Bujari do tē eci. Ti e di.

ZIGURI — Eu, dreq, se u ngatërrova! Kështu e kam nganjëherë, ngatërrohem... Po vjen doktor Astriti! Pra, që e patëm fjalën, unë atë ditë vrava trembëdhjetë thellëza dhe një alamet lepuri.

ASTRITI — Po ende me atë lepur ti, xha Ziguri??

ZIGURI — Pse, u mërzitke zotrote, kur unë vras lepura? (*Ela dhe Astriti qeshin*).

ASTRITI — Po mirë, ti e vrave një herë atë, që kur erdhe në spital. Tani përsëri kërkon ta vrasësh??!

ZIGURI — Po ta vras, more, ta vras që tē çuditet i madh e i vogël!

BUJARI — (*Jashtë skene*) Ela!

ELA — Erdha, Bujar, erdha! (*Kalon*).

ZIGURI — (*Në drejtim të sallës*) Epo plak éshtë ky, u thotë mendja, ia hedhim ne! Dhe vjen e ta gjen mu në... mu në mes tē muhabetit. Duket, nuk kanë pirë ujë me çapëzën e kërrabës ata, jo! Po dhe në hundëlesh nuk kanë përpjekur, pa dija unë si do tē mërziteshin. I bëja unë tē kërcenin si ariu, po ç' e do! Nejse, lere... E ku e patëm fjalën, se na... na e ngatërroi.

ASTRITI — (*Qesh*) Te lepuri.

ZIGURI — Jo, more! Te djali e patëm, te djali! Ai duhet tē eci (*Si sheh që Ela nuk éshtë*) Kujtova se mos ke ikur ti e pyeta, po paska ikur ajo!... (*Niset tē dal*) Ik, moj bijë, ik, se dashuria nuk éshtë për pleqtë!... (*Ndihet e goditura e shkopit*).

EPILOGU

Mëngjesi i doktor Gentit.

A.

Te Bujari, Ela dhe Astriti.

BUJARI — Ela më tha se Jona u nis.

ASTRITI — Po, maleve.

BUJARI — Po ti, do të vish në dasmën tonë, doktor?

ASTRITI — Patjetër, patjetër! (*Ela ka kafshuar gishtin dhe del e rrëmbyer*) E turpërove, Bujar!
(Qesh).

BUJARI — Kështu e ka ajo, sa herë që i përmend dasmën...

ASTRITI — Kujdes, pra, tjetër herë mos ia përmend.

BUJARI — Ah, doktor, është lodhur me mua aq shumë, sa... Dhe e kam mërzitur ndonjëherë pa të drejtë.

GENTI — (*Vjen me Elën*) Mirëmëngjes, djalosh!

BUJARI — Mirëmëngjes, doktor!

GENTI — Qenke në gaz sot!

BUJARI — Ç'të bëjmë! Qeshim me doktor Astritin, se na u zemërua Ela.

GENTI — Ela?! E pse të zemërohet Ela, ajo është vajzë e re!

ELA — Po ashtu flet ai, doktor, prandaj.

BUJARI — Po ti do vish në dasmën tonë, doktor? Dhe Jona do të vijë.

GENTI — Patjetër, patjetër!

ELA — Ja!... Nuk ke faj ti, jo!

ASTRITI — Mos u mërzit, Ela! Të gjithë do të vijmë.

GENTI — Më thanë se i ke thyer patericat, se do të ecësh vetë.

BUJARI — Mundohem, doktor!

GENTI — Nuk ke frikë?

ASTRITI — E ku kanë frikë trimat, doktor!

BUJARI — Megjithëse më dhemb ca shpatulla e djathtë, se duket u vrava keq, kur u rrëzova, po nuk kam frikë.

GENTI — Lëre tani shpatullën! (Astritit) Do të desha t'i çoj çantën Jonës, po thashë, përpara se të nisem..

ASTRITI — Të lutem, doktor!

GENTI — Pa çohu, Bujar! Shpejt, shpejt! (Bujari coroditet. Ela, e hutuar) Aaa, jo kështu! (I heq batanijen dhe e ndihmon. Bujari hedh hapin e parë. Zigurit, që sa ka ardhur, i bie shkopi nga dora) Ec, djalë, mos ki frikë!... Largojni ju, e mos e prekni!

ELA — Po, Bujar, mos ki frikë!

BUJARI — Ela! (Hedh hapin) Te Lugjet..

ELA — Po, Bujar, ec!

ZIGURI — Hë, qerrata! Thashë unë që do të ecësh dhe ja... Pyet doktorin, po nuk më besove!